

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR 2019

Tiranë
Janar 2020

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU"
Ndërtesa 1, Kati IV
Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel. : 00355 4 2258046
http: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Janar 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2019

**VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME**

JANAR, 2020

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Parathënie	3
Përmbledhje	5
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	12
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.....	12
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”	13
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	13
1.4 Trajnimet e Burimeve Njerëzore të ERRU-së.....	14
1.5 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	15
1.5.1 Licencimi i Operatorëve UK	15
1.5.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	17
1.5.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	20
1.5.4 Inspektimet	24
1.5.5 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve	27
1.5.6 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK	29
1.5.7 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK Nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore	30
1.6 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së	33
1.6.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	33
1.6.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	34
1.7 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	36
1.8 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së	37
1.8.1 Të Ardhurat.....	37
1.8.2 Shpenzimet Operative	37
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2019	40
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	47
4 Gjendja në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime	49
4.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2019	49
4.2 Subvencionet	54
4.3 Investimet në Sektorin UK për Vitin 2019	55
4.3.1 Investimet nga Buxheti i Shtetit.....	55
4.3.2 Investimet nga Donatorët e Huaj.....	56
5 Situata në Zbatim të Reformës në Sektorin e Ujit	57
6 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2020	59
7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit	60
Aneksi 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2019	61
Aneksi 2 - Vlera e Faturës Mujore (me TVSH) për Klientët Familjarë Viti 2019	63
Aneksi 3 - Shoqëritë e riorganizuar dhe të licencuara sipas reformës	64
Aneksi 4 – Trajnimet - Viti 2019	65
Aneksi 5 – Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2019	66
Aneksi 6 – Subvencionet e Akorduar nga Qeveria për Shoqëritë UK, Viti 2019	67

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura
UK	Ujësjetllës Kanalizime
U	Ujësjetllës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Kosovës
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomik
ERSAR	Rregullatori i Portugalisë
ERC	Rregullatori i Maqedonisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
NJQV	Njësitet e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
OM	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
GIZ	Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit

Parathënie

Raporti Vjetor 2019 paraqet aktivitetin dhe performancën e Entit Rregullator të Sektorit Ujësjellës Kanalizime (ERRU) në përmbushje të detyrimeve që e ngarkon ligji, si edhe në përmbushje të rekomandimeve të cituara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për ERRU-në për tu realizuar gjatë vitit 2019. Raporti paraqet gjithashtu edhe zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri, tendencat, performancat, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës të sektorit dhe të vetë institucionit.

ERRU si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve edhe gjatë vitit 2019 ka shtuar përpjekjet për përmirësimin cilësor të rezultateve të punës së tij mbështetur në kapacitet e saj gjithnjë në rritje. Në këtë kuptim ERRU ka shërbyer si promotor për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve, të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe të përballueshme financiarisht, dhe me një marrëdhënie sa më transparente me publikun.

Vit 2019 ka qenë vit i vazhdimësisë së reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Aktiviteti i ERRU-së gjatë këtij viti ka qenë mjaft intensiv. Kjo gjë shprehet qartë në numrin e madh të mbledhjeve të Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR), që krahas mbledhjeve të zakonshme të punës, ka zhvilluar tridhjetë e dy (32) mbledhje me Vendimmarrje, ku tematika kryesore e tyre ka konsistuar kryesisht:

- aprovim tarifash të reja të propozuara nga Shoqëritë UK
- licencime të Shoqërive UK
- trajtim i ankesave të konsumatorëve
- diskutime dhe miratim të dokumenteve që shërbejnë si instrumente të ndryshëm rregullatorë, si rregullore të trajtimit të ankesave të konsumatorëve, përballueshmëria e pagesave të faturave nga konsumatorët, etj.
- diskutime dhe rekomandime mbi dokumente strategjike në fushën e ujit të iniciuar nga aktorë të tjerë institucionale si, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), etj.
- Raportime dhe analiza mbi aktivitetin ekzekutiv të ERRU-së, etj.

Duhet theksuar fakti se ERRU-ja gjatë vitit 2019 ka përballuar një fluks mjaft të madh të aplikimeve për tarifa dhe licenca duke përfunduar procesin e miratimit të tarifave për dymbëdhjetë (12) Shoqëri UK, krahas miratimit të shtatëmbëdhjetë (17) licencave për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve.

ERRU ka përmirësuar cilësinë e analizave për tarifat e reja të propozuara nga shoqëritë UK sipas logjikës së një plani biznesi, dokument që është propozuar të bëhet kërkesë ligjore kur aplikohet për tarifa të reja. Shoqërive UK, gjithnjë e më shumë, iu kërkohet që të japin informacione të sakta e të detajuara në lidhje me kostot e shpenzimeve dhe justifikimin e tyre, si dhe i vendosen objektiva ambicioze në drejtim të uljes së humbjeve, si dhe të rritjes së normës së arkëtimit.

Si sfidë e së ardhmes për Shoqëritë UK dhe për Sektorin në përgjithësi mbetet rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike, si dhe ndërtimi i një organogramme efikase dhe me njerëz që justifikojnë vendin e punës në to.

Shprehje e rritjes së cilësisë së punës së ERRU-së gjatë vitit 2019 janë dhe përmirësimi, apo hartimi i instrumenteve të rinj rregullatorë, ku përmenden:

- “Metodologjia e Vendosjes së Tarifave”, aprovimi përfundimtar i tij nga KKRR pritet të bëhet mbasi të jetë aprovuar projekt-ligji i sektorit të ujit.
- “Rregullore mbi procedurën e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit UK me qëllim zgjidhjen sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të tyre.
- “Platforma e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime” e krijuar në mënyrë të pavarur nga ERRU-ja si nevojë për të rritur besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave.
- “Hartimi i Raportit të Bilancit të Ujit”, i konceptuar si model për hartimin e çdo raporti vjetor të bilancit të ujit për sektorin dhe për çdo Shoqëri UK, ku jepen orientime dhe rekomandime për hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike.
- “Studimi për Përbalueshmërinë” si një nga kriteret bazë që ERRU ka parasysh në analizën dhe miratimin e tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK, bazuar në të dhënat e detajuara në decila për shpenzimet mesatare mujore për familje që ofron INSTAT.

Në përmbushje të detyrimit ligjor të ERRU-së për monitorimin e sektorit UK, dhe Shoqërive UK, ERRU ka intensifikuar Inspektimet pranë shoqërive problematike, dhe nga ana tjetër ka rritur angazhimin në trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj Shoqërive UK.

ERRU ka intensifikuar marrëdhëniet bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, me Njësinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Autoritetin e Konkurrencës në mbrojtje të interesave të konsumatorëve.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe të cilësisë së aktivitetit të saj, ERRU ka intensifikuar gjithashtu bashkëpunimin me WAREG (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit), ku ERRU është anëtare me të drejta të plota, Programi i Danubit financiar nga Banka Botërore, IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), si dhe marrëdhëniet dypalëshe me rregullatorët në rajon, si Kosova, Maqedonia, Mal i Zi dhe ato të Evropës. Në këto të fundit më aktive janë bashkëpunimet me rregullatorët e Italisë, Skocisë dhe Portugalisë.

Raporti jep gjithashtu edhe një pasqyrim të situatës aktuale të sektorit. Sektori UK është në përfundim të riorganizimit sipas Reformës Territoriale. Në fund të vitit 2019 nga 57 shoqëritë UK, 49 prej tyre raportojnë të dhëna sipas zonave të reja të shërbimit në përputhje me kufijtë administrative të bashkive, por mbesin akoma 8 shoqëri të pa licencuara nga ERRU për shkak të problematikave ligjore për vlerësimin, transferimin dhe regjistrimin e tyre në QKB, si dhe të mos marrjes së Akt Miratimit Higjieno Sanitar. Referuar Treguesve Kryesorë të Performancës vërehet se gjendja në sektor në krahasim me vitin 2018 paraqet një përkeqësim në drejtim të mbulimit të kostove direkte të O&M. Ndërkohë që treguesit e Ujit Pa të Ardhura dhe të Normës së Arkëtimit Korrente mbeten në nivele të pandryshuara. Kjo tregon se në sektor janë rritur kostot për O&M, ndërkohë që të ardhurat kanë mbetur në nivele pothuaj të njëjta.

ERRU, në përmbushje të detyrimeve ligjore kundrejt sektorit UK dhe konsumatorëve, do të rrisë angazhimin për të forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndër institucional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

Raporti Vjetor 2019 i Aktivitetit të ERRU-së instrument informimi dhe transparence

Hartimi dhe publikimi i Raportit Vjetor 2019 të aktivitetit të ERRU-së përbën një detyrim ligjor me qëllim informimin dhe transparencën ndaj Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrisë, si dhe të transparencës në përgjithësi ndaj publikut dhe institucioneve që lidhen me sektorin e ujit.

Misioni i ERRU-së është "*Të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që operatorët e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ti ofrojnë ato me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme*".

Raporti përcakton në mënyrë të detajuar aktivitetin e ERRU-së të gjitha fushat e veprimtarisë së saj në përmbushje të misionit të mësipërm, si edhe objektivat e punës në të ardhmen për forcimin e rolit të tij si institucion i pavarur. Në një kapitull të veçantë raporti analizon gjendjen dhe performancën e sektorit të ujit, si dhe jepen rekomandime për rritjen e performancës së tij në të ardhmen.

ERRU, Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.

Baza kryesore ligjore e ushtrimit të aktivitetit të ERRU-së si institucion i pavarur është ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Ky ligj e ngarkon ERRU-në me përgjegjësitë e vendosjes së tarifave të shërbimeve UK për shoqëritë UK, licencimin e shoqërive UK, si edhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve për garantimin e shërbimeve cilësore nga shoqëritë UK, ndaj abuzimeve për shërbimet monopol të ujësjellës kanalizimeve të UN.

Licencimi i Shoqërive UK

Gjatë vitit 2019 janë licencuar 17 shoqëri. Në total janë të licencuara nga ERRU 49 nga totali prej 57 shoqëri UK, 2 shoqëri janë në proces rinovimi për efekt përfundimit të afatit, 4 shoqëri janë me licencë të pavlefshme dhe nuk kanë aplikuar gjatë vitit për rinovim licence kryesisht shoqëri UK të vogla, si dhe 2 shoqëri të reja të cilat nuk janë pajisur asnjëherë me licencë. Arsyet e moslicencimit të tyre lidhen sidomos me reformën administrative territoriale për shkak të vështirësisë së regjistrimit të aksioneve në QKB, ndarjes së aseteve, emërimin e drejtuesve teknike të kualifikuar, në pajisjen me Akt Miratimin Higjeno Sanitar nga ISHS.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zgjidhjen e problematikave të hasura duke ngritur shqetësimin pranë MIE dhe ISHS mbi nevojën e rishikimit të akteve nënligjore që kushtëzojnë kërkesat për emërimin e drejtuesve teknikë, veçanërisht për shoqëritë e vogla si dhe për të vendosur ligjërisht në kushte më praktike procesin e marrjes së Akt Miratimit Higjeno Sanitar.

Procesi i Miratimit të Tarifave për Shërbimet UK

Gjatë vitit 2019 ERRU ka miratuar tarifa për 12 shoqëri UK, përkatësisht Gjirokastër, Poliçan, Delvinë, Tropojë, Malësi e Madhe, Lushnje, Berat-Kuçovë, Vlorë, Krujë, Himarë, Vorë dhe Roskovec.

Aplikimet kanë patur si arsye kryesore unifikimin e tarifave në të gjithë zonën e re të shërbimit si pasojë e rritjes së saj pas reformës territoriale, si dhe për rritjen e të ardhurave për të mbuluar Kostot Direkte e Totale të shërbimeve UK.

Procesi i miratimit të tarifave nga ERRU shoqërohet me analiza të hollësishme që marrin në konsideratë vetëm kostot e arsyeshme dhe të justifikuar, të cilat duhet të jenë të lidhura ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Gjithashtu në miratimin e tarifave ERRU përdor kriterin e përbalueshmërisë së pagesës së faturës nga konsumatorët i cili aktualisht është 5% e shpenzimeve mesatare mujore për

familje. Zbatimi i këtij kriteri mjaft të rëndësishëm gjatë vitit 2019 është pasuruar me detaje të mëtejshme të vlerësimit të tij bazuar në të dhënat e reja që INSTAT vë në dispozicion për të ardhura mesatare mujore familjare në decila, si dhe duke marrë në konsideratë eksperiencat ndërkombëtare dhe ato Evropiane.

**Trajtimi i
Ankesave të
Konsumatorëve**

ERRU, nëpërmjet trajtimit të ankesave të konsumatorëve, synon garantimin që shoqëritë UK të veprojnë në përputhje me Kodin e Ujit (Rregullore e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve), si dhe kushtet e përgjithshme të kontratës që ato kanë me konsumatorët. Gjatë vitit 2019 ERRU ka shqyrtuar dhe trajtuar 18 ankesa të ardhura kryesisht nga konsumatorë familjarë. Natyra e ankesave të paraqitura pranë ERRU-së kanë qenë mbi faturimin aforfe si dhe cilësinë e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK. ERRU i ka trajtuar me seriozitetin maksimal dhe me objektivitet ankesat e konsumatorëve, nga të cilat 6 prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit ndërsa për ankesat e tjera konsumatorët janë rekomanduar ti drejtohen Gjykatës së shkallës së parë.

**Përmirësimi i
Standardeve në
Sektorin e UK
Nëpërmjet
Instrumenteve
Rregullatore**

Gjatë vitit 2019 ERRU, ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen me aplikimin për ndryshimin e tarifave, përkatësisht:

“Metodologjia e Vendosijes së Tarifave”, drafti i të cilës është përfunduar, duke përfshirë dhe eksperiencat më të mira nga konsultimi me Shoqatën e Rregullatorëve të Evropës WAREG. Aprovimi përfundimtar i tij nga KKRR pritet të bëhet mbasi të jetë aprovuar projekt-ligji i sektorit të ujit që lidhet me elemente të reja të draftit të metodologjisë së rishikuar të tarifave në pjesën e ligjit që trajton ERRU-në.

Drafti i ri merr parasysh realitetin e sektorit ku shumica e shoqërive UK janë të paqëndrueshme financiarisht, si dhe rastin për shoqëritë UK që kanë një performancë financiare shumë të mirë, të cilat aplikojnë për ndryshimin e tarifave për të mbuluar shlyerjen e kredive dhe nevojat për investime.

Metodologjia e re përfshin detyrimin që shoqëritë, kur propozojnë për tarifa të reja për mbulimin edhe të nevojave për investime fizike, të paraqesin një plan biznesi 5 vjeçar.

“Rregullore mbi procedurën e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vitin 2019 u miratua në prill të vitit 2019. Miratimi i saj erdhi në kuadër të qëllimit të mbrojtjes të konsumatorëve për një zgjidhje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të tyre duke vendosur rregulla më të qarta dhe të kuptueshme për palët, si dhe shtimin e mjeteve efikase si ndërmjetësimi apo seancat dëgjimore për zgjidhjen e ankesave në mbrojtje të interesave legjitime të konsumatorëve në një proces ankimi.

“Platforma e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujës-jellës Kanalizime” u miratua me vendimin nr. 31, datë 28.06.2019, si nevojë për të mënjanuar problematikat e vazhdueshme që ERRU ka patur në vite për varësinë e të dhënave të marra nga drejtorja e monitorimit të benchmark-ut pranë AKUM. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për hartimin e Raportit Vjetor të Performancës së shoqërive UK nga ERRU, por që vazhdimisht kanë paraqitur probleme të besueshmërisë dhe pasaktësisë së tyre.

Në këtë kuadër ERRU ka realizuar një platformë të saj të pavarur data baze në Excel lehtësisht e manipulueshme nga të gjitha shoqëritë e UK dhe jo e mbingarkuar që monitorohet nga ERRU. ERRU gjatë përpunimit të të dhënave të raportuara nga çdo shoqëri i kushton një vëmendje të veçantë saktësisë dhe besueshmërisë së tyre.

“Modeli i Hartimit të Raportit të Bilancit të Ujit” hartuar për vitin 2019, në të njëjtën kohë u konceptua si model për hartimin e çdo raporti vjetor të bilancit të ujit, jo vetëm për sektorin në përgjithësi, por edhe për çdo Shoqëri UK në veçanti. Në të jepen të dhëna dhe orientime të cilat shërbejnë për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe rekomandime në drejtim të planeve të veprimit që Shoqëritë UK duhet të ndjekin për reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, përkatësisht humbjeve administrative dhe fizike.

“Studimi për Përbalueshmërinë” realizuar gjatë vitit 2019, si një nga kriteret bazë që ERRU ka parasysh në miratimin e tarifave të propozuara nga Shoqëritë. Domosdoshmëria e një studimi më të thelluar si bazë për përdorimin e këtij kriteri ka rezultuar edhe gjatë rishikimit të metodologjisë së miratimit të tarifave nga ERRU gjatë vitit 2019. Studimi ka patur parasysh eksperiencën e rregullatorëve të tjerë të Evropës, si dhe mundësinë për të dhëna më të detajuara në decila për shpenzimet mesatare mujore që ofron INSTAT në vendin tonë. Studimi pati rëndësi gjithashtu për të vlerësuar mundësinë e lejuar nga kriteri i përbalueshmërisë që nga tarifat të mund të financohen plotësisht ose pjesërisht nevojat për investime fizike në sistemet e FU dhe KUN.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore vjetore të përcaktuara në kontratat me Shoqëritë UK si dhe pagesat për licencime.

Të ardhurat totale nga veprimtaria gjatë vitit 2019 janë 48.361.894 lekë.

Detyrimi vjetor 2019 i pagesave rregullatore referuar kontratave në fuqi me shoqëritë UK është 49.208.130 lekë që është pothuaj e përputhshme me vlerën e planifikuar.

Shpenzimet buxhetore të kryera nga ERRU gjatë vitit 2019, janë realizuar në shumën 40.136.857 lekë nga 50.249.000 lekë të planifikuara për tu shpenzuar gjatë vitit 2019. Arsyeja kryesore e uljes së shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara është kursimi nga tenderimi i zërave të parashikuara në buxhetin e vitit 2019, një pjesë nga pagat e Komisionerëve për periudhat e dorëheqjeve dhe emërimit të dy Komisionerëve, si dhe nga lejet e lindjeve për dy persona të stafit. Në mbyllje të vitit 2019, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU garanton plotësisht parashikimin e planit të shpenzimeve të vitit 2020.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e secilit operator dhe të sektorit në tërësi për shërbimet e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, në veçanti të shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU vitet e fundit. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2019 dhe tendencën e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2018 që jepen në tabelën e mëposhtme.

Treguesit e Performancës	Viti 2018	Viti 2019	Tendenca
Mbulimi me Furnizimin me Ujë (%)	77	77.2	↗
Mbulimi me Kanalizime (%)	52	52.9	↗
Mbulimi i Kostove O&M (%)	119	108.3	↘
Norma e Arkëtimit Korrente (%)	79	79	=
Niveli i Matjes (%)	74	77.5	↗
Ujë Pa të Ardhura (%)	63	63	=
Efiçenca e Stafit (stafi/1000lidhje UK)	5.35	5.31	↗

Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2019 tregojnë që gjendja në sektor në krahasim me vitin 2018 paraqet një përkeqësim në drejtim të mbulimit të Kostove Direkte të O&M, ndërkohë që treguesit e tjerë janë përmirësuar. Duke patur parasysh që treguesit e Ujit Pa të Ardhura dhe të Normës së Arkëtimit Korrente mbesin në nivele të pandryshuara, përkeqësimi i gjendjes financiare ka ardhur nga rritja e kostove të O&M, sepse të ardhurat kanë mbetur në nivele pothuaj të njëjta. Në detaje Treguesit Kryesorë të Performancës jepen, si më poshtë:

"Mbulimi me Furnizimin me Ujë" për vitin 2019 është pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin paraardhës. Përmirësimi i këtij treguesi kërkon investime të konsiderueshme fizike për të mbuluar me sisteme të furnizimit me ujë zonat e bardha rurale që i janë shtuar zonës së shërbimit të shoqërive mbas reformës territoriale.

"Mbulimi me Kanalizime" është rritur me rreth 1% krahasuar me vitin 2018 duke shënuar nivelin 52.9%, sepse popullsia e shërbyer është rritur me 152 850 banorë kundrejt popullsisë në juridiksion që është rritur me 232 621 banorë. Ndikim në rritje të popullsisë së shërbyer dhe të numrit të klientëve me kanalizime kanë dhënë investimet e kryera nga buxheti i shtetit. Raportohen akoma 54,323 lidhje që e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura me gropa septike. Përmirësimi i mëtejshëm i këtij treguesi kërkon investime të konsiderueshme fizike.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes"

Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" është treguesi që shpreh mbulimin me të ardhura të kostove për personelin, energjinë, kimikatet, qera, karburantin, shërbime të kontraktuara dhe kosto të tjera që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen. Në total për sektorin ky tregues paraqitet i qëndrueshëm financiarisht megjithëse është ulur nga 119% në 108.3%. Gjithsesi sektori paraqitet me probleme mjaft të mëdha në drejtim të performancës financiare ku vetëm 13 shoqëri arrijnë të performojnë mbi 100% të mbulimit të Kostove të O&M, ndërsa vetëm 4 prej tyre arrijnë të mbulojnë edhe Kostot Totale. Për vitin 2019, i gjithë sektori rezulton me mbulim të kostove të O&M mbi 100% si rezultat i ndikimit pozitiv mjaft të madh që jep UK Tirana që këtë tregues e ka 162% dhe përmban gati 1/3 e të gjithë klientëve të sektorit.

"Norma e Arkëtimit Korrente" është një tregues që përcakton nivelin e arkëtimit kundrejt faturimeve. Gjatë vitit 2019 ky tregues mbetet në nivelin e vitit 2018, pra 79 %. Ndër shoqëritë me nivele mjaft të ulta të këtij treguesi (nën 60%) janë UK Kukës, UK Divjakë, UK Kavajë, UK Gjirokastrë, UK Fier, UK Pustec, UK Roskovec, UK Elbasan. Shoqëritë UK Durrës dhe UK Vorë e justifikojnë uljen e këtij treguesi për shkak të tërmetit të fuqishëm të muajit nëntor. ERRU i vendos

objektiva agresive shoqërive UK gjatë miratimit të tarifave të reja me qëllim minimizimin e rritjes artificiale të tarifave në kurriz të një norme arkëtimi të ulët. **"Uji Pa të Ardura" (UPA)**, për vitin 2019 ka mbetur në nivelin e vitit 2018. Raportohen në total rreth 24,350 lidhje të reja dhe një rritje e volumit të faturimit me rreth 668 mijë m³ ujë/vit. Rritja e volumit të ujit të faturuar duhet të ishte më e konsiderueshme, por në rritjen minimalë të saj ka influencuar instalimi i 50 mijë matësave të cilat ulin konsumin mesatar, mesatarisht për familje me 4 persona nga 18 m³/muaj që presupozon faturimi aforfe, në rreth 12m³ në muaj për familje në faturimin me matje. Shoqëritë me performancë të dobët të këtij treguesi (mbi nivelin 70% UPA) paraqiten UK Berat Kuçovë, Cërrik, Durrës Fier dhe Vlorë. Për përmirësimin e UPA reforma në sektor po zbaton plane veprimi për lidhjet e paligjshme, pajisjen 100% të konsumatorëve me matësa, si dhe instalimin e matësave në burim. ERRU ka forcuar kërkesat dhe i ka ofruar një model shoqërive UK për të paraqitur një bilanc real të ujit në sistemet e tyre të furnizimit me ujë, si një element bazë për hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve dhe të UPA-s në përgjithësi.

"Niveli i Matjes" është përmirësuar me 3.5%, krahasuar me vitin 2018. Gjatë vitit janë instaluar rreth 50 mijë matësa uji. Në sektor ende raportohen 199,543 klientë pa matësa nga të cilët 8,201 janë të kategorisë jo familjarë. Konsumatorët duhet që të faturohen për volumin e ujit që ato konsumojnë dhe jo aforfe. Konstatohet se pothuajse të gjitha shoqëritë e kanë përmirësuar këtë tregues, ndërkohë që vetëm UK Devoll ka mundur të ketë 100% shërbimin e matur. Nëse do të vazhdohet me ritmet e dy viteve të fundit në mbyllje të vitit 2022 asnjë klient nuk do të faturohet aforfe, por sipas konsumit të matur.

"Eficienca e Stafit" është 5.31 punonjës për 1000 lidhje UK me një përmirësim të pa përfillshëm prej 0.04%. Gjatë vitit 2019 numri i lidhjeve të ujit është rritur me rreth 24,349 lidhje dhe ai i kanalizimeve me rreth 31,582 lidhje, por nuk ka patur efekt pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi sepse gjatë vitit 2019 në total stafi i shoqërive UK në sektor është rritur me 254 punonjës.

Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të plotësimit të detyrimit ligjor të garantimit të sigurisë së veprave të ujësjellësit me personel roje. Gjithsesi shoqëritë UK janë të mbingarkuara me punonjës të pajustificuar, rritja e të cilëve është evidente sidomos në vitet zgjedhore siç ishte viti 2019. ERRU ka forcuar kërkesat që Shoqëritë të justifikojnë secilin pozicion të stafit të saj dhe me përshkrimin përkatës të punës.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" është përmirësuar si tregues 13.2 orë/24 kundrejt 12.7 që ishte përgjatë vitit 2018. Në fakt raportimi i këtij treguesi duhet marrë me rezervë pasi ai vlerësohet apriori dhe jo në vlerësime të hollësishme sipas zonave shpërndarëse të shërbimit.

Vlerësimi përfundimtar mbi performancën e sektorit do të jepet nga ERRU në raportin vjetor për performancën e vitit 2019 ku është mundësia e një vlerësimi më të detajuar dhe të përjashtimit të ndonjë të dhëne evidente të pabesueshme.

Investimet në Sektor nga Buxheti dhe Donatorët

Sektori i ujësjellës kanalizimeve në vendin tonë ka nevoja mjaft të mëdha për investime fizike për të përmbushur kërkesat e Direktivës Evropiane të Ujit. Nevojat për investime fizike në sektor janë për rreth 5 miliard Euro, që përkon me një vlerë prej rreth 200 milion Euro/vit e projektuar në 25 vite. Qeveria Qendrore për vitin 2019 ka shpenzuar një fond investimesh në fushën e UK prej 4,432 miliard lekë, ekuivalente me rreth 35 milion Euro, nga të cilat rreth 300 milion lekë në mbështetje të reformës në sektor, ku përmenden objekte dhe sisteme të FU dhe KUN në bashkitë, përkatësisht, Durrës 76,6 milion lekë, Malësi

e Madhe 50 milion lekë, Rrogozhinë 49,5 milion lekë, Vau i Dejës 35 milion lekë, si dhe për studime dhe projektme për rreth 80 milion lekë.

Donatorët e huaj gjatë vitit 2019 kanë investuar në total rreth 34 milion Euro, ku veçohen ato të financuara nga BB dhe BEI për Durrësin, projekti në mbështetje të rrjetit hidrik të Tiranës financuar nga Qeveria Italiane, si dhe programi i infrastrukturës bashkiake III dhe IV financuar nga KfW dhe SECO. Vlera e investimeve të financuara nga donatorët e huaj është pothuajse e barabartë me atë të Qeverisë Qendrore. Totali prej rreth 70 milion Euro përfaqëson rreth 35 % të nevojave të sektorit prej 200 milion Euro/vit e shtrirë për një periudhë 25 vjeçare.

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2020**

- ❖ Në rast të mos aprovimit të projekt-ligjit të ri për sektorin e ujësjellës kanalizimeve të ndjekë procedurat për rishikimin e Ligjit nr. 8102 deri në miratimin përfundimtar të tij.
- ❖ Përfundimin e punës për rishikimin dhe hartimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave për shërbimin e UK", në përputhje me kërkesat për një menaxhim bashkëkohor të sektorit dhe përfshirjen e eksperiencave më të mira të rregullatorëve Evropianë në të.
- ❖ Me mbështetjen e asistencës së donatorëve të synojë rishikimin e Kodit të Ujit (Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime).
- ❖ Me mbështetjen e asistencës së donatorëve të synohet hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, përfshirë dhe trajnimet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shumë shoqërive UK në sektor, si një nga drejtimet kryesore të strategjisë për përmirësimin e performancës në sektor mjaft të fragmentarizuar me 57 shoqëri UK.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues për rishikimin e nën akteve ligjore që lidhen me Akt Miratimin Higjieno Sanitar që duhet të përfitojnë Shoqëritë UK për tu pajisur me Licence nga ERRU.
- ❖ Të hartojë dhe të botojë raportin vjetor të performancës së sektorit UK për vitin 2019 bazuar në platformën e data bazës të miratuar nga KKRR me të dhënat e grumbulluara nga shoqëritë UK të përmirësuara në drejtim të saktësisë dhe besueshmërisë.
- ❖ ERRU të forcojë përpjekjet për forcimin e rolit të ERRU në mbështetje dhe asistencë për zgjidhjen e problemeve me ankesat e konsumatorëve në respektim të Kodit të Ujit në veçanti, dhe të legjislacionit në fushën e ujësjellës kanalizimeve në përgjithësi.
- ❖ Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjëra dhe bilaterale me rregullatorët Evropianë të sektorit të ujit.
- ❖ Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK dhe në veçanti të kuadrit rregullator.

- ❖ Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorëve të tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve.

***Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës së
Sektorit UK dhe
të ERRU-së***

- Rishikimi dhe aprovimi i ndryshimeve të ligjit nr. 8102 për Entin Rregullator të Ujit të propozuara nga ERRU në Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht miratimit ose jo të projekt-ligjit për sektorin e ujit.
- Shfuqizimi i Kodit aktual të Ujit (Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime) dhe rishikimi dhe aprovimi i tij nga ERRU, si domosdoshmëri në përgjigje të kërkesave aktuale të sektorit, dhe në veçanti për një marrëdhënie dhe trajtim sa më objektiv të ankesave të konsumatorëve.
- Hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK nga ERRU, si dokumenti bazë në mbështetje të justifikimit të tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK, dhe si instrument i domosdoshëm për përmirësimin e manaxhimit të shoqërive në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tyre.
- Hartimi i nën akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjeno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nën akteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rrisht të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, si një domosdoshmëri për zgjidhjen e problemit të licencimit të shoqërive UK.
- Të nisë sa më shpejt të jetë e mundur procesi i agregimit të Shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës bazuar në principin “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, ku ERRU duhet të para vlerësojë tarifën e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Të nxitet përmirësimi i performancës së Shoqërive UK nëpërmjet hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Tregues Performance dhe Objektiva të vlerësuara në përputhje me gjendjen reale të Shoqërive UK dhe ambicioze për të ardhmen.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i cili e bazon veprimtarinë e tij në aktet ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre si më poshtë:

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (ligji nr. 120/2016);
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligj nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (Kodi i Procedurës Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480).

ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Qëllimi kryesor i ligjit nr. 8102 është mbrojtja e interesave publike dhe krijimi i një mjedisi transparent dhe ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Lidhur me legjislacionin ku ERRU duhet të ushtrojë përgjegjësitë e veta ligjore përmendim:

Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë me kosto më të ulët, reduktimit të procedurave, si dhe sigurimit të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

Në rastet kur do të lindin mosmarrëveshje mbi refuzimin e aksesit apo termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe çmimin, ERRU do të jetë autoriteti përgjegjës për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, kur aksesit është kërkuar nga një sipërmarrës i komunikimit elektronik të një

operator rrjeti që vepron në sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Gjithashtu ligji nr. 71/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar” parashikon ngritjen pranë ERRU të një strukture për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe operatorëve për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”

ERRU nuk është subjekt i detyrimeve ndërkombëtare, si dhe i rekomandimeve të “Progresraportit për Shqipërinë” që duhen plotësuar prej saj.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit, miratohen me vendim të Kuvendit.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit është Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Struktura organizative e ERRU-së, jepet në figurën 1.




Figura 1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU-ja ka përballë reformës së sektorit ujësjellës kanalizime që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

ERRU, në vazhdimësi, do të propozojë ndryshime të strukturës organizative në funksion të përmirësimit të performancës së saj, si aktor kryesor në sektorin e ujit, dhe në përgjigje të kërkesave të reja që parashtron vazhdimësia e reformës në sektorin e ujit dhe rritja e performancës së saj në përgjithësi.

1.4 Trajnimet e Burimeve Njerëzore të ERRU-së

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU-ja ka përballë reformës territoriale të sektorit ujësjellës kanalizime që burojnë nga objektivat strategjike të institucionit.

Në përputhje me sa më sipër janë përcaktuar objektivat e trajnimit për vitin 2019 sipas niveleve të ndryshme të organizimit. Objektivi bazë mbetet përshtatshmëria e aftësive të punonjësit me punën që kryen i cili synon të zhvillojë dhe të ruajë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve, me qëllim për t'u bërë më efektiv në punën që kryen ose për ta përgatitur për detyrat dhe angazhimet në të ardhmen. Trajnimet janë zhvilluar pranë shoqatave dhe institucioneve publike brenda dhe jashtë vendit.

Trajnimet jashtë vendit kanë shërbyer për të inkurajuar shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencës në mënyrë që stafi të njihet me praktikat më të mira të fushës dhe jepen të përmbledhura në Tabelën 1 ndërsa detaje të trajnimeve për tematikat dhe secilin Drejtor të ERRU-së jepen në Aneks 4.

Tabela 1. Trajnimet e Stafit të Erru-së Gjatë Vitit 2019

Staf Sipas Drejtorive	Brenda vendit (ditë)	Jashtë vendit (ditë)	Përqindja e trajnimeve brenda vendit	Përqindja e trajnimeve jashtë vendit
Staf nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	13	0	17%	0%
Staf nga Drejtoria Teknike-Ekonomike	48	34	63%	61%
Staf nga Drejtoria Juridike dhe Konsumatorit	15	22	20%	39%
Totali në Ditë	76	56		
Totali në Përqindje	58%	42%		

1.5 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.5.1 Licencimi i Operatorëve UK

Enti Rregullator i Ujit ka vazhduar të kryejë funksionet e tij, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK në lidhje me licencimin e tyre. Gjatë vitit 2019, në sektorin ujësjellës kanalizime kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 57 shoqëri për kategorinë e shërbimit të "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik". Nga këto shoqëri vetëm 2 prej tyre kryejnë "përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik", 52 prej tyre edhe atë të "grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura" dhe vetëm 4 shoqëri UK disponojnë në licencë kategorinë e "përpunimit të ujërave të ndotura".

Në vendin tonë aktualisht vazhdojnë të jenë në funksion tetë (8) impiante të përpunimit të ujërave të ndotura, katër (4) prej të cilave nuk janë të licencuara nga ERRU. Këto të fundit nuk kanë arritur ende të plotësojnë kërkesat për plotësimin e dokumentacionit përkatës që duhet të paraqesin pranë ERRU-së për marrjen e licencës për këtë kategori shërbimi.

Gjatë vitit 2019 ERRU ka pranuar njëzetë e pesë (25) aplikime për licencë nga 17 shoqëri UK sepse disa prej tyre, përkatësisht, UK si Gjirokastër, Dibër, Berat - Kuçovë dhe Vau i Dejës kanë aplikuar 2 herë, si për arsye ndryshimi drejtuesi ligjor/ drejtuesi teknik edhe për mbarim afati.

Në detaje arsyet kryesore të aplikimeve për licencim kanë qenë:

- a) përfundimi i afatit të licencës për të cilën kanë aplikuar 10 (dhjetë) shoqëri;
- b) ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik për të cilën kanë aplikuar 13 (trembëdhjetë) shoqëri;
- c) aplikim për herë të parë kanë aplikuar 2 (dy) shoqëri, përkatësisht U Këlcyrë dhe UK Pustec.

Ndër shoqëritë që kanë aplikuar gjatë viti 2019 për shkak të skadimit të afatit të licencës vitet e shkuara, shkaqet kryesore të vonesës kanë konsistuar në mosarritjen e përmbushjes së kushteve, si më poshtë:

- **UK Këlcyrë**, (u licencua për herë të parë) pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme ndër vite nuk ka arritur të plotësojë dokumentacionin përkatës, si për mos regjistrimin në QKB për inventarin e aseteve, mos pajisjen me Akt Miratimin Higjieno Sanitar, Drejtues teknik me kualifikimin e nevojshëm.
- **UK Mallakastër**, e licencuar rishtas pas një kalvari të gjatë të procedurave me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për shkak të pamundësisë së reflektimeve ndër vite të ndryshimeve të ndodhura në shoqëri, kryesisht të ish anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës.
- **UK Peqin**, e licencuar rishtas pas përpjekjeve të vazhdueshme për tu pajisur me Akt Miratimin Higjieno Sanitar nga mos përmbushja e treguesve të fortësisë së ujit në burim.
- **UK Fushë Arrëz**, e licencuar rishtas me vonesë për shkak se nuk arrinte të gjente një drejtues teknik sipas kërkesave të VKM-së së licencimit.

Gjithsesi nga 17 shoqëritë UK të licencuara nga ERRU gjatë vitit 2019, shtatë (7) prej tyre, nuk e kanë përfunduar atë për të gjithë territorin administrativ të bashkisë. Përkatësisht për shoqëritë UK Himarë

dhe UK Fushë Arrëz arsyeja kryesore ka qenë moskryerja e inventarit të plotë të aseteve të shoqërisë kryesisht për zonat shtesë rurale mbas riorganizimit, si për shkak të mungesës së informacionit por edhe të fondeve të nevojshme që kërkon ekspertiza për këtë qëllim.

Shoqëritë UK Mallakastër, UK Përmet dhe UK Fier nuk kanë arritur të përftojnë Akt Miratimin Higjieno Sanitar për të gjithë zonën e shërbimit/administrative të bashkisë.

Ndërkohë shoqëritë UK Peqin dhe UK Këlcyrë kanë licencë të kufizuar vetëm për pjesën e territorit që disponohen asete të inventarizuara të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Si përfundim, gjatë vitit 2019 nga KKRR janë marrë njëzet (20) Vendime licencimi në favor të (17) shoqërive, ndërsa nga njëzet e pesë (25) aplikime në total të paraqitura pranë ERRU-së mbeten akoma në proces pesë (5) prej tyre. (shih aneksi 1, tabela 1).

Për të gjithë Sektorin e Ujesjelles Kanalizimeve përbërë nga 57 shoqëri UK, situata e licencimit deri në fund të vitit 2019, paraqitet, si më poshtë:


- Dyzet e nëntë (49) operatorë disponojnë licenca të vlefshme, pavarësisht se 3 prej tyre janë në proces aplikimi për ndryshim të drejtuesit teknik të tyre;
- Dy (2) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës, nuk po arrijnë të pajisen me Akt-Miratimin Higjieno - Sanitar.
- Katër (4) operatorë janë me licencë të pavlefshme dhe nuk kanë aplikuar gjatë vitit për rinovim licence, për arsye se:
 - U Divjakë ka probleme me regjistrimin dhe përditësimin në QKB. Kjo është një shoqëri që edhe pse ERRU ka zhvilluar disa takime dhe me pas dhe inspektim ku në mbështetje të saj i kërkoi që të vinin të licencoheshin për zonën ekzistuese, por shoqëria nuk bëri asnjë përpjekje dhe për këtë KKRR doli me vendimin e masës administrative me gjobë.
 - UK Mirditë i mbaroi afati i licencës në nëntor të këtij viti dhe nuk arriti të plotësonte dosjen për rinovim licence.
 - UK Selenicë nuk është riorganizuar ende. Problematika është mos përditësimi i QKB dhe kalimi në një nivel administrimi si dhe shtyrja e afateve të Këshillit të Administrimit, si dhe borxhet e mëdha të pashlyera.
 - UK Bulqizë nuk është riorganizuar ende. Sipas reformës duhej të bashkohej me U Krastë, gjithashtu problematikë është mos pajisja me akt miratim Higjieno – Sanitar për zonat e reja që ka marrë nga reforma.
- Dy (2) operatorë janë të rinj dhe nuk janë pajisur asnjëherë me licencë, UK Kamëz dhe UK Klos pasi nuk kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për licencim.

Siç u përmend më sipër dy nga aplikimet që janë akoma në proces mbeten problematike sepse këto shoqëri momentalisht e kanë të pamundur të plotësojnë kërkesat për liçensim të shoqërive UK në zbatim të VKM nr. 958, përkatësisht për:

- Marrjen e akt-miratimit higjieno-sanitar, nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë.
- Emërimin e drejtuesve teknikë, të kualifikuar sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958;

Vështirësitë që shoqëritë po hasin për përmbushjen e këtyre kushteve vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për licencimin dhe rinovimin e licencës në kohë të shoqërive UK.

Gjendja e Licencimit të Sektorit jepet gjithashtu në Grafikon 1



Grafiku 1. Situata aktuale e licencimit

Në grafikun 1, jepet situata e licencimit në përqindje, ndërsa për secilën nga 57 shoqëritë UK jepet në Aneks 1, Tabela 2, ndërsa e detajuar për çdo shoqëri jepet në Aneks 1, Tabela 1

Në veçanti problematika akoma pezull që hasin Shoqëritë UK për përfundimin e Akt Miratimit Higjieno Sanitar trajtohet në kapitujt e mëtejshëm të raportit.

1.5.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

Në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.06.1998, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ERRU është autoriteti që miraton tarifat e shërbimeve UK në përputhje me metodologjinë e aprovuar prej saj të përllogaritjes së tarifave.

Objektivi kryesor i ERRU-së në procesin e miratimit të tarifave është gjetja dhe respektimi i balancës, nga njëra anë të mbrojtjes së interesit të konsumatorëve, por edhe rritjen dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënien e mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun (konsumatorët) në zonën e shërbimit, dhe vazhdon me analizën nga stafi teknik i ERRU-së dhe diskutimin dhe miratimin e tyre përfundimtar me Vendim të veçantë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij procesi, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), bazuar në kompetencat që i jep ligji, ka miratuar nën-aktet ligjore përkatëse të detyrueshme që lidhen me mënyrën e aplikimit nga shoqëritë, analizën dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, përkatësisht:

- Vendimi nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" ;

- Vendimi nr. 40, datë 09.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";
- Vendimi nr. 41, datë 09.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";
- Vendimi nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";

Shoqëritë e riorganizuar e kanë detyrim ligjor që të aplikojnë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave të reja, për unifikim të tyre, por dhe për tarifa të diferencuara brenda zonës së shërbimit duke patur parasysh diferencat në cilësinë e shërbimit brenda saj, kryesisht ato ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale.

Gjatë vitit 2019 kanë përfunduar procedurën dhe janë marrë vendimet për miratimin e tarifave të reja për 12 shoqëri ujësjellës kanalizime si në Tabelën 2.

Tabela 2. Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendimet për ndryshimin e tarifave

Nr.	Operatori	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit
1	UK Gjirokastrë	7	08.02.2019
2	UK Poliçan	8	08.02.2019
3	UK Delvinë	13	06.03.2019
4	UK Tropojë	29	28.06.2019
5	UK Malësi e Madhe	30	28.06.2019
6	UK Lushnje	41	28.08.2019
7	UK Berat-Kuçovë	48	10.10.2019
8	UK Vlorë	51	28.10.2019
9	UK Krujë	52	28.10.2019
10	UK Himarë	53	28.10.2019
11	UK Vorë	68	19.12.2019
12	UK Roskovec	69	30.12.2019

Me përjashtim të shoqërisë UK Malësi e Madhe e cila ka aplikuar gjatë vitit 2019 për nivel tarifor vetëm për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, 11 shoqëritë e tjera kanë qenë në proces aplikimi nga viti kaluar 2018 dhe kanë aplikua bazuar në bilancin vjetorë të certifikuar nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar për vitin 2018.

Deri në mbyllje të vitit 2019 nuk ka asnjë shoqëri tjetër që të ketë filluar procedurën e aplikimit për tarifa dhe të jetë në proces shqyrtimi pranë ERRU.

Argumentimi bazë i aplikimeve nga Shoqëritë UK gjatë vitit 2019 ka konsistuar kryesisht në:

- Përmbyshjen e detyrimit ligjor që shoqëritë duhet të aplikojnë tarifa të reja sipas parashikimeve të pikës 3 të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e

operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, nga nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit të tyre. Mbas riorganizimit për shoqëritë në zonën e re të shërbimit ekzistojnë tarifa të ndryshme në vende të ndryshme të njësisë së re administrative (ish komunat) që duhen unifikuar, ose mungesa e tyre për zonat që dikur nuk janë shërbyer nga asnjë shoqëri UK.

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, që i jep të drejtën Shoqërive të aplikojnë për tarifa të reja nga nevoja për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Theksohet fakti që ERRU ka përballuar një volum mjaft të madh pune dhe me mjaft cilësi për të analizuar dhe miratuar dymbëdhjetë (12) aplikime për tarifa të reja nga Shoqëritë UK, ku procesi për analizën dhe miratimin vetëm të një tarife nga ERRU kërkon të paktën një periudhe kohe prej tre muajsh. Prosesi është shoqëruar me një bashkëpunim të ngushtë me stafet e Shoqërive UK për të saktësuar të gjithë elementet e nevojshëm tekniko-ekonomike që influencojnë në përcaktimin dhe miratimin përfundimtar të tarifave në zbatim të kriterëve që ERRU ka vendosur dhe zbaton në këtë proces.

Projekt-Vendimet paraprake të KKRR janë shoqëruar gjithnjë me raporte analizash mjaft të detajuara, si për vlerësimin e performancës aktuale të shoqërive, edhe për objektivat e vendosura nga ERRU për Shoqërinë në të ardhmen. Kjo gjë evidentohet edhe nga fakti që të gjitha Projekt-Vendimet para se të marrin formën e vendimit përfundimtar nga ERRU, janë konfirmuar nga Shoqëritë dhe bashkitë përkatëse, si edhe nga Autoriteti i Konkurrencës.

Në procesin e aplikimeve dhe të analizës për propozimet për tarifa të reja gjithsesi mbetet akoma problem pasaktësia e informacionit si dhe mangësitë në dokumentacion. Kjo ka detyruar dhe ERRU-në që në shumë raste të jetë vetë prezentë pranë shoqërive me qëllim mbështetjen e saj ndaj tyre. Ky fenomen konstatohet veçanërisht në shoqëritë e reja ku kapacitetet njerëzore nuk janë në nivelin e duhur, por në disa raste edhe në shoqëritë me eksperiencë. Kjo gjë ka bërë që analizat dhe vendimmarrjet për këto shoqëri të zgjaten në afatet kohore, derisa të plotësohet dokumentacioni në përputhje me standardet e përcaktuara në Metodologjinë e Vendosijes së Tarifave.

Saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave vazhdon të mbetet një shqetësim dhe nga ana tjetër prioritet i punës së ERRU-së, reflektuar kjo në analizën teknike ekonomike të aplikimeve për miratim tarifash për shërbimet UK. Për këtë arsye ERRU gjatë vitit 2019 ka organizuar mbledhjen e përpunimin e të dhënave direkt nga shoqëritë dhe llogaritjen e Treguesve të Performancës të cilat shërbejnë për një analizë të ecurisë së shoqërisë, si edhe për përcaktimin e objektivave që shoqëria duhet të përmbushë në të ardhmen. ERRU po monitoron nga afër procesin e raportimit dhe të besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga Shoqëritë, ku për të dhëna që paraqiten me besueshmëri jo të pranueshme, krahas diskutimeve me stafin teknik të Shoqërive realizohen edhe vizita në vend për verifikimin e tyre.

ERRU gjatë analizës së aplikimeve për aprovimin e tarifave të reja nga shoqëritë UK ka parasysh kriterin që me nivelin tarifor të miratuar të synohet mbulimi i kostove të O&M, dhe për shoqëri më të

avancuara në drejtim të qëndrueshmërisë financiare, të mbulohen edhe Kostot Totale që përfshijnë dhe nevojat për investime fizike. Këto kosto duhet të mbulohen me të ardhura bazuar gjithashtu në një Normë Arkëtimi të arsyeshme (pranueshme) të faturave të klientëve.

Kriteri tjetër bazë që ERRU ka gjatë analizës së vlerësimit të tarifave të reja është ai i Përballueshmërisë së faturës nga ana e konsumatorit në mbrojtje të interesave të tij.

ERRU përdor si kriter për përballueshmërinë e pagesës së faturës së shërbimeve UK, nivelin prej 5% të të ardhurave (shpenzimeve) mesatare mujore të një njësie ekonomike familjare, informacion që e kalkulon dhe e publikon INSTAT “Anketa e Buxhetit të familjes viti 2017”, për të gjithë qarqet e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat e INSTAT nga “Anketa e Buxhetit të familjes viti 2018” nuk kanë qenë të disponueshme gjatë vitit 2019 për tu përdorur si kriter për Përballueshmërinë, kështu që është operuar me ato të vitit 2017.

Trajtimi i problemit të përballueshmërisë bazuar në të dhënat e INSTAT është mënyra më objektive e vlerësimit të tij, mënyrë e cila jep një tablo më të qartë edhe të reagimit të pritshëm nga publiku kur propozohet rritja e tarifave, si dhe të ndërtimit të politikave sociale nga qeveria qendrore dhe ajo lokale. Konstatohet fakti se akoma ka mjaft hapësirë për rritjen e tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duke respektuar njëkohësisht kriterin e përballueshmërisë.

Përgjithësisht trendi i ndryshimit të tarifave ka qenë rritës por në vendimmarrjet e vitit 2019 në ndonjë rast të veçantë rishikimi i tarifave për kategori të ndryshme të konsumatorëve ka patur dhe tendencë për tarifa më të ulëta se ekzistueset.

Konstatohet se shumë shoqëri janë në vështirësi reale financiare, nevoja për subvencione nga qeveria është e domosdoshme për një periudhë më afat gjatë. Në këtë kategori përfshihen kryesisht shoqëritë e Grupit të III-të ose shoqëritë e vogla që për shkak të mungesës së ekonomisë së shkallës duhet të aplikojnë tarifa jashtëzakonisht të larta që bien ndesh me kriterin e Përballueshmërisë dhe subvencionimi nga Qeveria Qendrore ose Lokale duhet të vazhdojë edhe për një periudhë kohe të mëtejshme deri në realizimin e strategjisë së agregimit të tyre në shoqëri më të mëdha.

1.5.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2019 Enti Rregullator i Ujit ishte pjesë e 12 proceseve gjyqësore, 9 prej të cilave të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullatore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime. Pas përpjekjeve të vazhdueshme të Entit për nxitjen e shoqërive për shlyerjen e pagesave rregullatore, detyrimet e akumuluar në vite detyruan ERRU-në ti drejtohej gjykatës për zgjidhjen e problematikës së krijuar.

Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Rrogzhinë sh.a.
Objekti: Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Rrogzhinë sh.a" të shlyejë shumën 778 200 lekë si një detyrim i prapambetur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Rrogzhinë sh.a t'i paguajë ERRU shumën 778 200 lekë.

2. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.
Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Krujë" sh.a. të paguajë shumën prej 1,386,200 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Krujë sh.a t'i paguajë ERRU shumën 1,386,200 lekë.

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Kurbin (Laç) sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Kurbin sh.a.
Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Kurbin" sh.a. të paguajë shumën 2,000,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Kurbin dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Kurbin sh.a t'i paguajë ERRU shumën 2,000,000 lekë.

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Dibër sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Dibër sh.a.
Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Dibër sh.a. të paguajë shumën 1,557,500 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Dibër sh.a t'i paguajë ERRU shumën 1,557,500 lekë.

5. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a.

Objekti: *Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a. të paguajë shumën 3,220,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.*

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Pogradec dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor **u vendos që shoqëria UK Pogradec sh.a t'i paguajë ERRU shumën 3,220,000 lekë.**

6. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë sh.a.

Objekti: *Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë” sh.a. të paguajë shumën 1,376,150 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.*

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor **u vendos që shoqëria UK Tepelenë sh.a t'i paguajë ERRU shumën 1,376,150 lekë.**

7. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Ura Vajguore sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Ura Vajguore sh.a.

Objekti: *Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Ura Vajguore” sh.a. të paguajë shumën 472,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.*

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor **u vendos që shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Ura Vajguore sh.a t'i paguajë ERRU shumën 472,000 lekë.**

8. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a.

Pala Paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a.

Objekti: *Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Peqin” sh.a. të paguajë shumën 960,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.*

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.**

9. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Selenicë sh.a.

Pala Paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Pala e Paditur: Ujësjetllës Kanalizime Selenicë sh.a.

Objekti: *Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Selenicë" sh.a. të paguajë shumën 351,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.*

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtarë.**

10. Komiteti shqiptarë i Helsinkit – Enti Rregullator i Ujit

Pala Paditëse: Komiteti Shqiptarë i Helsinkit

Pala e Paditur: 1. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë;
2. Këshilli Bashkiak, Tiranë;
3. Komisioni (Këshilli) Kombëtar Rregullatorë, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura;

Person i tretë: 1. Bashkia Tiranë;

2. Avokatura e Shtetit;

Objekti:- *Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të:*

Propozimit për rritjen e tarifave të ujit, drejtuar Entit Rregullatorë të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për rishikimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura nr. prot 13132, datë 29.06.2017 dhe shkresën me nr. prot 14275, datë 20.07.2017 me lëndë "Kërkohe mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm";

Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm";

Vendimit e Këshillit Kombëtar Rregullatorë, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a."

Rregullimin nga gjykata të pasojave të derivuara nga aktet e përmendura më sipër (absolutisht të pavlefshme)

Ndalimi për të ardhmen i efekteve (pasojave) të akteve administrative të sipërcituara, absolutisht të pavlefshme.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe **në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos rrëzimi i kërkesë padisë.**

11. Aida Gojani - Enti Rregullator i Ujit

Palë paditëse: Aida Gojani

Palë e paditur: Enti Rregullator i Ujit

Objekti: *Detyrimi i palës së paditur Enti Rregullator i Ujit që të paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë për periudhën 21.08.2006 deri më 03.08.2014 periudhë gjatë së cilës kam ushtruar detyrën e Anëtarit të Komisionit Kombëtarë të Entit*

Rregullator të Ujit në masën e 4 pagave mujore referuar pagës mujore në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës e cila është 146,150 lekë.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana Gjykatës së Lartë Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.

12. Luena Brekofca - Enti Rregullator i Ujit

<i>Palë Paditëse:</i>	Luena Brekofca
<i>Palë e Paditur:</i>	Enti Rregullator i Ujit
<i>Objekti:</i>	<ol style="list-style-type: none"><i>1. Shfuqizim i vendimit nr.15, datë 25.03.2019 "Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës";</i><i>2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuar , përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;</i><i>3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;</i><i>4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;</i><i>5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditëshi për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysëm shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;</i>

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.

1.5.4 Inspektimet

Gjatë vitit 2019, Enti Rregullator i Ujit ka intensifikuar kontrollet pranë shoqërive UK që operojnë në sektor duke zhvilluar inspektime pranë tyre bazuar në procedurën e miratuar sipas ***Rregullores së Inspektimit dhe Monitorimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimit në Sektorin Ujësjellës Kanalizime***, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, përkatësisht të neneve 15, 22 dhe 32/1. Nenet e mësipërme lidhen kryesisht me zbatimin e detyrimeve ligjore që kanë shoqëritë për tu licencuar dhe miratuar tarifat e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve pranë ERRU-se, si dhe të penalteteve që parashikohen për mosrespektimin e tyre.

Theksohet fakti se ERRU nuk e ka konsideruar inspektimin thjeshtë si instrument ligjor masash administrative, por në shërbim dhe të qëllimit të rritjes së cilësisë së shërbimit të operatorëve, pa anashkaluar zbatimin rigoroz të dispozitave ligjore. Për këtë arsye para se të arrihet në marrjen e masave administrative ERRU ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm si dhe me takime paraprake me

drejtuesit e Shoqërive dhe Kryetarët e Bashkive përkatëse për zgjidhjen e problematikave dhe zbatimin e detyrimeve ligjore që shoqëritë duhet të respektojnë.

Kështu gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) inspektime pranë shoqërive ujësjellës kanalizime dhe si rezultat i tyre u konstatua dhe u morën masat si më poshtë:

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Divjakë sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë. Për këto arsye ndaj UK Divjakë u mor masa administrative gjobë në shumën 300 000 lekë për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë .

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës sh.a. nuk zbatonte vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 74, datë 19.10.2018 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik të sh.a ujësjellës kanalizime Vau Dejës", por me një Vendim të kundraligjshëm të këshillit bashkiak vazhdonte të aplikonte tarifat e mëparshme. Kjo situatë u konstatua dy (2) muaj para zgjedhjeve lokale të vitit 2019. Për këtë arsye ERU vendosi që shoqëria UK Vau Dejës të aplikonte vendimin e dhënë nga Komisioni Kombëtar Rregullator duke kundërshtuar vendimin e kundraligjshëm të këshillit bashkiak.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Pustec sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë. Kjo Shoqëri gjithashtu ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me tarifa të pa miratuara nga ERU. Për Shoqërinë UK Pustec bazuar kryesisht në gjendjen e vështirë ekonomike të saj u vendos ti lihet afati deri në 31 dhjetor 2020 për pajisjen me licencë dhe të aplikojë për tarifa pranë ERU dhe të përdorë tarifa të miratuara nga kjo e fundit.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Fushë Arrëz sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë. Kjo Shoqëri gjithashtu ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me tarifa të pa miratuara nga ERU. Për Shoqërinë UK Fushë Arrëz bazuar kryesisht në gjendjen e vështirë ekonomike të saj u vendos që të bëhet licencimi i saj për vetëm zonën ekzistuese (jo të riorganizuar). Gjithashtu kësaj shoqërie i lihet afati 1 (një) vjeçar për ri licencim sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 (re riorganizuar) dhe të aplikojë për tarifa pranë ERU dhe të përdorë tarifa të miratuara nga kjo e fundit.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Fier ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë, si dhe nuk ka paguar detyrimet financiare të prapambetura ndaj ERU-së. Pengesa kryesore e Shoqërisë për liçensim ka qenë mos pajisja me Akt Miratimin Higjiëno Sanitar nga pengesa burokratike dhe qëndrime të ngurtësuara nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik për lëshimin e këtij akti. Për Shoqërinë UK Fier u vendos ri-inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim zgjidhjen e problemit të Akt Miratimit Higjiëno Sanitar, ndërsa për pagesat rregullatorë u arrit firmosja e një marrëveshje me ERU-në për pagesat e prapambetura dhe brenda një periudhe kohe të arsyeshme me këste mujore.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Përmet ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë që nga data 13.01.2017, si dhe kishte detyrime financiare të prapambetura të pagesës rregullatore. Arsyet e mos licencimit edhe në këtë rast ishin për shkak të mos marrjes së Akt Miratimit Higjiëno Sanitar nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik me arsyetimin

se shoqëria po kryente investime në rrjetin e brendshëm të qytetit, ndërsa për mos pagesën rregullatore justifikimi ishte për shkak të gjendjes së dobët financiare të shoqërisë. Gjithsesi pas Inspektimit shoqëria arriti të likuidonte gjysmën e detyrimit financiarë të prapambetur. Për këtë shoqëri u vendos ri inspektimi i saj brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë mbas mbarimit të afatit të saj me datë 17.07.2018. Gjithashtu kjo shoqëri nuk është riorganizuar ende sipas reformës pasi nuk ka kryer vlerësimin e aseteve si dhe nuk ka marrë akoma në dorëzim nga bashkia Njësinë Administrative të Krastës e cila më parë ka funksionuar si ndërmarrje UK dhe ka shumë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Gjithashtu problematik për këtë shoqëri është edhe mos pajisja me akt miratim Higjieno – Sanitar për zonat e reja të shërbimit. Për sa më sipër pas detyrave të lëna nga ERRU u vendos ri inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë që mbas mbarimit të afatit të saj me datë 01.09.2000, si dhe ofron shërbimet me tarifa të pa miratuara nga ERRU. Arsyet e mos licencimit të kësaj shoqërie kanë qenë të shumta si pasojë e akumulimit të problematikave të ndryshme në vite. Shoqëria nuk arrinte të regjistrohej në QKB sepse nuk kishte historik të Këshillave Mbikëqyrëse (kopje të dokumentave të identifikimit të anëtarëve) dhe të bilanceve financiare ndër vite, si edhe detyrime të mbartura për sigurimet e punonjësve ndër vite, detyrime ndaj OSSHE-së dhe të tretëve. Gjithashtu problematik për këtë shoqëri ishte edhe pajisja me akt miratimet higjieno sanitare, kjo si pasojë e burokracive nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, çështje e cila ishte adresuar deri në Kryeministri nga drejtuesi i shoqërisë. Pas detyrave të lëna nga ERRU u vendos ri inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Këlcyrë edhe pse ofronte prej vitesh shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura nuk ka patur licencë të vlefshme nga ERRU pasi nuk kishte arritur asnjëherë të plotësonte dokumentacionin përkatës për licencim edhe pse me këtë shoqëri nga ana e ERRU-së janë zhvilluar takime të shumta në këtë drejtim.

Arsyet e mos licencimit të shoqërisë ishin të shumta pasi shoqëria nuk ishte riorganizuar akoma sipas reformës dhe nuk kishte bërë regjistrimet përkatëse në QKB, mungesa e gjetjes së një drejtuesi teknik të kualifikuar si dhe mungesa e Akt Miratimit Higjieno sanitarë pasi sipas Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik nuk plotësonte kushtet për marrjen e saj për të gjithë zonën e shërbimit. Gjatë inspektimit nga shoqëria u bënë prezent dokumenta ku u informuam se kishin avancuar në plotësimin e dokumentacionit përkatës për licencim. Nisur nga kjo për shoqërinë UK Këlcyrë nga ERRU u vendos ri inspektimi i saj brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Selenicë ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë pas përfundimit të afatit të saj me datë 30.04.2016 si dhe kishte detyrime financiare të prapambetura të pagesës rregullatore për të cilat ka edhe një proces të hapur gjyqësorë me ERRU-në. Arsyet e mos licencimit edhe për këtë shoqëri kanë qenë të ndryshme si mos përditësimi i QKB dhe kalimi në një nivel administrimi, shtyrja e afateve të Këshillit të Administrimit, vlerësimi dhe inventarizimi i aseteve për zonat e reja sipas reformës si dhe borxhet e

mëdha që kjo shoqëri mbart si pasojë e një situatë shumë të rënduar financiare. ERRU gjatë kësaj kohe ka zhvilluar një sërë takimesh me këtë shoqëri me praninë edhe të kryetarit të bashkisë së saj ku janë informuar mbi detyrimet që ka shoqëria UK Selenicë për licencim dhe zbatimin e VKM nr.63 për riorganizimin e shoqërive UK. Në përfundim për shoqërinë UK Selenicë u vendos aplikimi i saj për licencim për zonën ekzistuese të shërbimit dhe ri inspektim i saj brenda 6 muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë pas përfundimit të afatit të saj me datë 05.10.2018. Kjo për shkak se shoqëria nuk arrin të pajiset me Akt Miratimin Higjiëno Sanitar. Shoqëria pretendon se janë plotësuar të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e akt miratimit higjiëno sanitar, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo e vërtetuar edhe me shkresat përcjellëse të cilat u bënë prezent gjatë inspektimit. Në këto kushte u vendos ri inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë mbas mbarimit të afatit të saj me datë 25.11.2018. Arsytet e mos aplikimit të kësaj shoqërie për licencim pranë ERRU-së ishin si rezultat i mos riorganizimit të saj sipas reformës, pasi kjo shoqëri duhej të bashkohej me shoqërinë Elbasan Fshat. Proces ky që ishte drejt përfundimit dhe u konstatua në momentin e inspektimit. Për Shoqërinë UK Elbasan nga ERRU u vendos ti lihet një afat 2 (dy) mujorë në lidhje me përfundimin e procesit të licencimit.

Inspektimet e realizuara patën efekt pozitiv në drejtim të përmbushjes së detyrimeve nga ana e shoqërive UK të detyrave të lëna nga grupet e inspektimit, ku si rezultat i tyre vlen të theksohet licencimi i disa shoqërive të cilat prej vitesh operonin pa një licencë të miratuar nga ERRU, si UK Fushë Arrëz, Këlcyrë dhe Mallakastër gjithashtu u licencuan edhe shoqëritë UK Elbasan, Përmet dhe Fier.

Problematikë kryesore e mos licencimit të shoqërive UK mbetet rishikimi i bazës ligjore në lidhje me kërkesat dhe kriteret për pajisjen e shoqërive UK me Akt Miratimin Higjiëno Sanitar.

Me aktet dhe nën aktet e legjislacionit aktual në fuqi procedura e marrjes së Akt Miratimin Higjiëno Sanitar nga Shoqëritë UK është pothuajse e pamundur të respektohet praktikisht. ERRU që në vitin 2018 e ka ngritur këtë shqetësim në nivelin e dy Ministrive përgjegjëse, përkatësisht MIE dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe me Inspektoratin Shtetëror të Shëndetësisë, por akoma zgjidhja e këtij problemi ka mbetur pezull.

Gjithsesi inspektimet dhe marrja e masave administrative ndaj shoqërive UK, të cilat nuk përmbushin në kohë apo nuk zbatojnë detyrimet ligjore që kanë ndaj ERRU-së do të jenë në fokus të punës së institucionit edhe gjatë vitit 2020, si i vetmi mjet jo parësor, por i nevojshëm për të bërë të mundur zbatimin e ligjit nga shoqëritë UK dhe duke ndikuar kështu edhe në rregullimin e sektorit në tërësi.

1.5.5 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve

Entit Rregullator të Ujit ka detyrimin ligjor që nëpërmjet trajtimit të ankesave të konsumatorëve, të sigurojë që dhënia e shërbimit nga ana e shoqërive UK të jetë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Si referencë kryesore ligjore që trajton detyrimet dhe të drejtat e palëve Shoqëri-Konsumator, është rregullorja për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit (Kodi i Ujit), si edhe

Licenca me të gjitha kushtet që e shoqërojnë atë, kontrata model e aprovuar ndërmjet Shoqërisë dhe konsumatorit etj.

Spektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit për vitin 2019 ka shqyrtuar dhe trajtuar 18 ankesa, të ardhura kryesisht nga konsumatorë familjarë. Subjekti kryesor i ankesave të drejtuara pranë ERRU-së ka qenë mbifaturimi aforfe, probleme të moszbatimit të kontratës nga ana e shoqërisë ndaj konsumatorëve, kryesisht mbi cilësinë e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK.

Tabela 3 jep të detajuara sipas objektit ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2019

Tabela 3. Ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2019

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1	Faturimi Aforfe	7	1
2	Probleme me kontratat	1	0
3	Mbi faturimi	4	1
4	Cilësia e shërbimit	6	4
TOTALI		18	6

Nga totali i të gjithë ankesave, 6 prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Ankesat e paraqitura në ERRU me objekt “anullim i faturimit aforfe” vijojnë të zënë numrin më të madh të ankesave edhe gjatë vitit 2019. Këto lloj ankesash, evidentojnë se shoqëritë UK nuk kanë respektuar normat prej 4.5 m³/muaj/frymë për konsumatorët familjarë në rastet e faturimit aforfe të miratuara nga Këshilli i Ministrave, kryesisht duke faturuar një numër personash të pajustificuar (me të madh) sipas gjendjes familjare të konsumatorëve. Në fakt ERRU ka dhënë në mënyrë të vazhdueshme rekomandimin që shoqëritë duhet të kenë prioritet të tyre pajisjen 100% me matësa të konsumatorëve për të eliminuar faturime të tilla jo korrekte.

Nga ana tjetër, është vënë re një neglizhencë nga ana e konsumatorëve, të cilët nuk respektojnë afatin kohor të së drejtës për ankimim që citohet në aktin e Kodit të Ujit. Kjo ka sjellë shpesh herë akumulimin e një shume detyrimi të konsumatorëve që ankimohet ndaj shoqërisë në vlera mjaft të mëdha dhe të papërbalueshme që bëhen subjekt i trajtimit si çështje gjyqësore ndërmjet palëve.

Zgjidhja e këtyre ankesave vazhdon të jetë një sfidë për rregullatorin për shkak të defektit të mos ankimimit në kohë nga ana e konsumatorëve të shkeljeve të tilla. Një nga objektivat kryesorë të rregullatorit për vitin 2020 është dakordësimi dhe bashkëpunimi me shoqëritë UK për të gjetur një zgjidhje për këto lloj ankesash pa ju drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore.

Vihet re një ndërgjegjësim gjithnjë e më i madh i konsumatorëve për marrjen e një shërbimi cilësor, për rrjedhojë dhe shtimin e numrit të ankesave me objekt “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK”. Këto ankesa kanë pasur objekt ankimimi cilësinë e ujit, mosrespektimin në kohë të procedurave nga ana e shoqërive UK ndaj nevojave dhe defekteve të konsumatorëve, si dhe kohëzgjatjen e furnizimit me ujë. Këto lloj ankesash kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme dhe të favorshme për konsumatorët të cilët i janë drejtuar ERRU-së.

Në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e një zgjidhjeje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve, si dhe në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vitin 2019, ERRU miratoi në muajin Prill 2019 “Rregullore mbi procedurën e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar”. Një objektiv i rëndësishëm i këtij instrumenti rregullator është vendosja e rregullave më të qarta dhe të kuptueshme nga personat e interesuar, mjetet si ndërmjetësimi apo seancat dëgjimore për zgjidhjen e ankesave, si dhe garantimi i mbrojtjes së interesave legjitime të konsumatorëve në një proces ankimimi.

ERRU, në rolin e ndërmjetësuesit, është përpjekur për t’u dhënë rekomandimet e duhura palëve, veçanërisht shoqërive UK për të respektuar të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime.

Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare, ERRU në zbatim objektivave të saj ka ofruar asistencë në dhënien e informacionit, shpjegimeve dhe konsultime verbale dhe me e-mail, telefon për të gjithë konsumatorët e interesuar të cilët janë drejtuar pranë ERRU-së për të gjetur një zgjidhje të shqetësimit të tyre për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Ligji nr. 8102 i atribuon Entit Rregullator të Ujit përgjegjësinë dhe detyrën për të mbrojtur konsumatorët nga çmimet monopol si dhe të gjejë një ekuilibër të drejtë midis interesave të tyre dhe operatorëve në sektorin e furnizimit me ujë. Nga ana tjetër, nëpërmjet trajtimit të ankesave, mbrojtja e konsumatorëve është e orientuar drejt garantimit që shoqëritë UK të veprojnë në përputhje me rregulloren për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit me kushtet e licencës së tyre, kushtet e përgjithshme të kontratës model duke siguruar kështu cilësinë, efikasitetin dhe vazhdueshmërinë e shërbimit.

Gjithsesi shoqëritë në të gjitha rastet duhet të mbajnë përgjegjësitë e tyre në trajtimin e ankesave dhe duhet të trajtojnë konsumatorin si palë në zgjidhjen e ankesave. Konstatohet në mënyrë të dukshme që Shoqëritë duhet të përmirësojnë performancën e tyre në drejtim të marrëdhënieve me konsumatorët, të transparencës, komunikimit dhe të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale. Ato duhet të forcojnë mënyrën e komunikimit dhe të ndërgjegjësimit të konsumatorëve, gjithashtu për detyrimet e këtyre të fundit në respektim të akteve dhe normave ligjore në fuqi, gjë e cila do të sjellë reduktimin apo eliminimin e situatave dhe ankimeve të mësipërme që vijnë nga mungesa e njohjes për respektimin e këtyre detyrimeve.

1.5.6 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së operatorëve të shërbimit UK dhe sektorit në tërësi merr një rëndësi të veçantë për të pasur një sektor financiarisht të qëndrueshëm, i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët. Rezultatet e monitorimit të shoqërive UK janë publikuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet Raportit Vjetor të Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime dhe Sektorit që hartohet nga ERRU që nga viti 2011.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i Raportit Vjetor të Performancës ka për qëllim transparencën me të gjithë aktorët e interesuar, në radhë të parë konsumatorët për njohjen dhe vlerësimin e performancës së operatorit të tyre lokal, problematikat në ofrimin e shërbimeve, si dhe krahasimin me atë që ato konstatojnë realisht në praktikë. Nga ana tjetër ato njihen gjithashtu me rekomandimet për zgjidhjen e tyre me angazhimet e Shoqërisë dhe me investimet përkatëse që nevojiten.

Nëpërmjet publikimit të këtij raporti synohet nxitja e të gjithë aktorëve në sektor si, operatorët, kryetarët e bashkive, këshillat administrative, konsumatorët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë vendorë dhe qendrorë për t'u angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen. Një rëndësi të veçantë marrin në raport rekomandimet me të cilat duhet të njihen si drejtuesit e Shoqërive, por dhe instancat e larta vendimmarrëse të Qeverisë Qendrore dhe Lokale.

Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre. Gjatë vitit 2019 dhe në vijim, ERRU i ka kushtuar vëmendje forcimit të rolit të tij monitorues për sektorin duke e konsideruar atë si një element shumë të rëndësishëm në veçanti kur Shoqëritë UK aplikojnë për tarifa.

Theksohet fakti se deri në vitin 2018 Shoqëritë UK raportonin të dhënat operative tekniko ekonomike pranë AKUM, të dhëna të cilat deri në këtë periudhë janë përdorur për hartimin e Raportit Vjetor të Performancës së Shoqërive UK dhe Sektorit nga ERRU. Në këtë lloj varësie ERRU në mjaft raste ka hasur me problematika të dhënies në kohë dhe sidomos të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave që rrezikon në arritjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve jo të drejta për përmirësimin e performancës së sektorit.

Në këtë situatë ERRU mori iniciativën për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave (data baze) për të gjitha shoqëritë e UK, platformë e cila u konceptua dhe u zbatua gjatë vitit 2019. Kjo ka forcuar përgjegjësinë e saj për monitorimin sa më të saktë dhe pranë realitetit të shoqërive UK që operojnë në sektor. Pajisja e ERRU-së me bazën e saj të të dhënave dhe benchmarkut është bazuar në kompetencat që i jep ligji 8102 që ngarkon ERRU-në për monitorimin e shoqërive që operojnë në Sektorin Ujësjiellës Kanalizime.

Theksohet fakti që ERRU me një angazhim maksimal ka arritur që Raporti Vjetor i Performancës së Shoqërive UK dhe Sektorit për vitin 2018 të publikohet në fund të Qershorit 2019. Duke patur parasysh që të dhënat janë të disponueshme në muajin Maj, koha për verifikim të dhënash dhe hartimin e raportit brenda afatit të mësipërm është mjaft e shkurtër.

1.5.7 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK Nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore

Një nga kompetencat e KKRR është miratimi i rregullave dhe nën akteve për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të tij të parashikuara në ligj. Në këtë drejtim, ERRU gjatë vitit 2018 ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen kryesisht me aplikimin për ndryshimin e tarifave. Në këtë kuadër ERRU ka rishikuar dokumentet e mëposhtme;

“Metodologjia e Vendosijes së Tarifave”. Në vijim të ngritjes së grupit të punës në fund të vitit 2017 për rishikimin e Metodologjisë së Vendosijes së Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 18, datë 22.03.2018 vendosi “Për fillimin e procedurës për ndryshimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave”. Ndryshimet konsistojnë kryesisht në:

- Rishikimin e metodologjisë, duke marrë parasysh realitetin e operatorëve në sektor nisur nga fakti se shumica e tyre janë të paqëndrueshme financiarisht, si dhe nga ana tjetër operatorë që kanë një performancë financiare dhe operative shumë të mirë, të cilat aplikojnë për ndryshimin e tarifave me qëllim akumulimin e të ardhurave për shlyerjen e kredive dhe për të mbuluar nevojat për investime;
- Rishikimin e gamës së treguesve kryesorë të performancës të përmendura më sipër;
- Domosdoshmërinë e përgatitjes së planeve të biznesit 5 vjeçar për të hartuar një propozim për tarifa të reja, konsistent e të projektuar për perspektivën pesë vjeçare të aktivitetit të shoqërisë, si dhe detyrimin që shoqëritë UK të paraqesin një raport vjetor performance pranë ERRU-së, në përputhje me planin e biznesit dhe zbatimit të tarifave të aprovuara nga ERRU;
- Rishikimin e skemës së procesit të aplikimit në drejtim të aspektit praktik të saj.

Nisur nga sa më sipër, Grupi i Punës konkludoi në draftin final, i cili iu dërgua për shqyrtim KKRR-së. Miratimi i metodologjisë së vendosjes së tarifave, i rishikuar, ishte planifikuar të përfundonte në fund të vitit 2019, por ky proces u shty për shkak të pritjes për aprovim të projekt-ligjit për sektorin e ujësjellës kanalizimeve, ligj i cili përfshin dhe përmbajtjen e ligjit aktual ligjin nr. 8102 të ERRU-së dhe me ndryshime që lidhen me metodologjinë e vendosjes së tarifave.

“Rregullore mbi procedurën e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” u miratua në prill të vitit 2019. Miratimi i saj erdhi në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e një zgjidhjeje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve, si dhe në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vitin 2019. Një objektivi i rëndësishëm i këtij instrumenti rregullator është vendosja e rregullave sa më të qarta dhe të kuptueshme nga personat e interesuar, shtimi i mjeteve efikase si ndërmjetësimi apo seancat dëgjimore për zgjidhjen e ankesave si dhe garantimi i mbrojtjes së interesave legjitime të konsumatorëve në një proces ankimi.

“Platforma e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime” e cila u miratua me vendimin nr. 31, datë 28.06.2019, lindi si një nevojë për të mënjanuar problematikat e vazhdueshme që ERRU ka patur në vite për varësinë e të dhënave të marra nga drejtoria e monitorimit të benchmark-ut pranë AKUM të cilat janë përdorur si bazë për hartimin e Raportit Vjetor të Performancës së shoqërive UK. Kjo ka ardhur si domosdoshmëri gjithashtu për të minimizuar problemin kronik të vërtetësisë dhe pasaktësisë së të dhënave që ka influencuar në cilësinë e konkluzioneve për përmirësimin e performancës së sektorit.

Në këtë situatë ERRU mori iniciativën për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave (data baze) për të gjitha shoqëritë e UK, platformë e cila u konceptua dhe u zbatua gjatë vitit 2019, bazuar gjithashtu në kompetencat që i jep ligji 8102 që ngarkon ERRU-në për monitorimin e shoqërive që operojnë në Sektorin Ujësjellës Kanalizime.

Data baze është orientuar në sensin praktik për të mos e ngarkuar me të dhëna që për momentin

mund të jenë të tepërta për sektorin e UK dhe nuk i shërbejnë qëllimit për të patur një data baze efikase dhe me të dhëna sa më të sakta dhe lehtësisht të përdorshme. Platforma llogarit automatikisht Treguesit Kryesorë të Performancës, si bazë dhe për përgatitjen e Raportit Vjetor të Performancës.

Forma e saj e zhvilluar në Excel është konceptuar i ndarë në sete të veçanta për secilin lloj të shërbimeve që ofrojnë shoqëritë në sektor dhe që janë të sanksionuara në licencën e tyre.

Platforma në Excel ka një dimension të vogël lehtësisht i dërgueshëm me e-mail dhe u testua paraprakisht në 11 Shoqëri UK. Raportimi me e-mail nga shoqëritë në ERRU do të bëhet 2 herë në vit (1 raportim 6 mujor dhe një raportim vjetor).

ERRU hartimin dhe publikimi e Raportit Vjetor të Performancës së shoqërive UK për vitin 2019 do ta realizojë bazuar në të dhënat e grumbulluara nga sektori i monitorimit dhe performancës pranë ERRU-së.

ERRU është e bindur që platforma e re e raportimit të të dhënave, kontrolli i vazhdueshëm nga stafi i ERRU-së për të dhëna që dyshohen si jo të besueshme do të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen e përgjegjshmërisë nga ana e shoqërive e cila do të çojë në raportime të sakta dhe të drejta të të dhënave të raportuara nga ana e tyre.

“Modeli i Hartimit të Raportit të Bilancit të Ujit” i hartuar për vitin 2019, në të njëjtën kohë u konceptua si model për hartimin e çdo raporti vjetor të bilancit të ujit, jo vetëm për sektorin në përgjithësi, por edhe për çdo Shoqëri UK në veçanti. Raporti i Bilancit Vjetor të Ujit për vitin 2019 iu dërgua të gjithë Shoqërive UK me sqarimet e nevojshme për mënyrën/modelin e hartimit të bilancit të ujit prej tyre në të ardhmen që duhet të depozitohen pranë ERRU-së. Në të jepen të dhëna dhe orientime të cilat shërbejnë për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe rekomandime në drejtim të planeve të veprimit që Shoqëritë UK duhet të ndjekin për reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, përkatësisht për përbërësit kryesorë të humbjeve administrative dhe atyre fizike.

“Studimi për Përballueshmërinë” është realizuar gjatë vitit 2019 nga ERRU dhe është prezantuar gjithashtu në Konferencën Ballkanike Vjetore për Ujin në Prishtinë organizuar nga SHUKALB dhe SHUKOS në Nëntor 2019. Përballueshmëria është një nga kriteret bazë që ERRU ka parasysh në analizën dhe miratimin e tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK. Domosdoshmëria e një studimi me të thelluar si bazë për përdorimin e këtij kriteri ka rezultuar edhe gjatë rishikimit të metodologjisë së miratimit të tarifave nga ERRU gjatë vitit 2019. Studimi ka patur parasysh eksperiencën e rregullatorëve të tjerë të Europës për këtë kriter, si dhe mundësinë për të dhëna më të detajuara në decila për shpenzimet mesatare mujore që ofron INSTAT në vendin tonë. Krahasimi bëhet në lidhje me shpenzimet mesatare mujore të familjeve (të nëntë decilave të para duke përjashtuar shtresën e pasur) për pragun e pranuar prej 5% të përballueshmërisë. Studimi pati rendësi gjithashtu për të vlerësuar mundësinë e lejuar nga kriteri i përballueshmërisë që nga tarifat të mund të financohen plotësisht ose pjesërisht nevojat për investime fizike në sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura.

1.6 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERU-së

Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale janë dy instrumente kryesore të ERU-së për të shprehur qëndrimin dhe kontributin e saj në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit ujësjellës kanalizime dhe nga ana tjetër, e përfitimit dhe forcimit institucional nga eksperiencat ndërkombëtare rregullatore.

1.6.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.6.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2019 ka konsistuar me informimin periodik të veprimtarisë institucionale të rregullatorit si dhe të gjendjes së sektorit të ujit nëpërmjet raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Gjithashtu në vijim të zbatimit të mekanizmit ndërinstitucional për forcimin e sistemit të monitorimit të të dhënave dhe rekomandimeve të institucioneve të pavarura, bashkëpunimi me Kuvendin ka vazhduar me takimet e organizuara nga Kryetari i Kuvendit si dhe është raportuar periodikisht (çdo 4 muaj) mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në rezolutën e Kuvendit.

1.6.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Në kuadër të implementimit të reformës së ndërmarrë për riorganizimin e sektorit të ujit, edhe për vitin 2019 ka vijuar bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. ERU ka kontribuar dhe ka përcjellë qasjen rregullatore në rishikimin e dokumenteve sektoriale. Konkretisht ERU ka dhënë kontribut mjaft aktiv si pjesë e Grupeve të Punës për hartimin e dokumentit-projekt të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, dhe të dokumentit-projekt të Ligjit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.

1.6.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të zbatimit të Memorandum Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës, ERU gjatë vitit 2019 ka vijuar bashkëpunimin me këtë institucion me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjen e interesave publike në sektorin e ujit.

Gjatë vitit 2019, ERU ka kërkuar dhe ka marrë në konsideratë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për 12 projekt vendime për miratimin e nivelit të ri tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura dhe ia ka përcjellë ato Shoqërive UK përkatëse.

1.6.1.4 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

Edhe për vitin 2019, ERU ka vijuar bashkëpunimin me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore duke dhënë kontributin e saj në takime pune dhe workshope ku fokusi i këtij viti ka qenë evidentimi i nevojave dhe problematikave që ka sot menaxhimi i burimeve ujore në kontekstin financiar. Për këtë arsye, në Workshopin Kombëtar për financimin e Sektorit të Ujit zhvilluar në Tetor 2019, ERU ka mbajtur një prezantim mbi "Synimin e përfshirjes së kostove të menaxhimit të burimeve ujore në tarifatat për shërbimet UK".

Në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 157 datë 28.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit ndërsektorial të integruar" ERU është pjesë e Grupit të Punës për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP). Në

takimet e Grupit të Punës gjatë vitit 2019, krahas njohjes dhe trajtimit të problemeve të bazës aktuale ligjore, është trajtuar edhe analizuar përputhshmëria e Planit Buxhetor Afat-mesëm me Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore.

1.6.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizatat ndërkombëtare është konsideruar nga ERRU si një ndër elementet kryesorë që i shërben forcimit institucional dhe kapaciteteve, kryesisht të rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj profesional në aspektet rregullatore.

1.6.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare

Enti Rregullator i Ujit është anëtar me të drejta të plota i shoqatës së rregullatorëve evropiane të ujit WAREG. ERRU e konsideron mjaft të domosdoshme dhe si fushë kryesorë të aktivitetit ndërkombëtar të saj pjesëmarrjen aktive në këtë organizatë ku fokusi kryesor është bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencës në çështjet që prekin rregullatorët në ditët e sotme duke pasur parasysh zhvillimet e shpejta që pëson sektori i Ujit.

Gjatë vitit 2019, ERRU ka marrë pjesë aktive në të tre mbledhjet e Asamblesë së WAREG të cilat kanë konsistuar si më poshtë:

- WAREG, Mbledhja 17-të e Asamblesë në Dublin, Irlandë më 12 – 13 Shkurt 2019. Tematika “Plani i veprimit të WAREG për vitet 2020 - 2022”; “Krijimi i marrëdhënieve me institucionet Evropiane”. Fokusi kryesor në planin e veprimit ishte metodologjia e tarifave, ku ERRU ishte pjesë e Task Forcës së ngritur për këtë qëllim. Gjithashtu u zhvillua një seminar me temë Instrumentet rregullatorë për promovimin e efikasitetit të shërbimeve të ujit, si dhe reforma strukturale në sektorin e ujit në Evropë.
- WAREG, Mbledhja e 18-të e Asamblesë në Vilnius, Lituani më 21-22 Maj 2019. Workshopi Seminar mbi monitorimin dhe rregullimin e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në Evropë". Gjithashtu u analizuan raportet e Task Forcës mbi investimet ku ERRU ishte pjesë e saj.
- WAREG, Mbledhje e 19-të e Asamblesë në Budapest, Hungari, 05 - 06 shtator 2019, ku fokusi kryesor ishte seminari mbi raportin e Task Forcës hartuar mbi metodologjinë e miratimit të tarifave në vendet Evropiane.

Pjesëmarrja dhe angazhimi në këtë organizatë, ka dhënë mundësinë për trajtime të çështjeve të tjera rregullatore si aksesimi i vazhdueshëm i ujit të pijshëm, nevojat për investime, apo forcimi i rolit të rregullatorit në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të niveleve të ndryshëm për të zhvilluar një strukturë të tillë transparente, të qëndrueshme e të harmonizuar në ndihmë si të operatorëve dhe të konsumatorëve.

Në Prill të vitit 2019, ERRU mori pjesë në takimin e radhës së Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (**NER**) në Paris të Francës, të krijuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (**OECD**). Tematika e këtij viti ishte diskutimi mbi pyetëtorin dhe studimin e zhvilluar tek rregullatorët mbi qeverisjen e rregullatorëve kundrejt pavarësisë, llogaridhënies dhe hapave që ndërmarrin në

zhvillimin e sektorëve si energjia, telekomunikacioni, uji. Gjithashtu fokusi i diskutimeve edhe për këtë vit nga ky rrjet ishte përshtatja e rregullatorit me zhvillimin e shpejtë teknologjik që pësojnë sektorët.

Gjatë vitit 2018 ERRU vijoi gjithashtu bashkëpunimin në nivel përfaqësimi me **Programin e Ujit për Rajonin e Danubit** të mbështetur nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime. Ky program më datë 20 - 22 Maj 2019 organizoi konferencën vjetore të Danubit për Ujin në Vjenë të Austrisë me tematikë kryesore: “Arritja e qëndrueshmërisë në shërbimet ujësjetllës kanalizime në rajonin e Danubit”. Konferenca, me përfaqësues të sektorit të ujit nga më shumë se 15 vende të ndryshme diskutoi progresin, sfidat dhe veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren në të ardhmen për një shërbim të qëndrueshëm për të gjithë rajonin e Danubit.

Në Shtator të vitit 2019, si anëtare me të drejta të plota të shoqatës ndërkombëtare të Ujit IWA, mori pjesë në konferencën për rajonin juglindor të Evropës me tematikë “Humbjet e Ujit për vitin 2019” e zhvilluar në bashkëpunim me Shoqatën e ujit të Rumanisë. Synimi i kësaj konference ishte prezantimi dhe diskutimi i zhvillimeve më të fundit, strategjive dhe praktikave më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e humbjeve të ujit dhe nevoja emergjente për përmirësimin e sektorit të ujit sa i përket humbjeve në këtë rajon.

1.6.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtar dhe Ndërkombëtar

Si çdo vit, edhe përgjatë vitit 2019, ERRU ka vijuar bashkëpunimin me takime pune, pjesëmarrje në aktivitete dhe prezantime me donatorët që operojnë në sektorin e ujit. Si një nga aktorët kryesor në sektor, ERRU ka vijuar bashkëpunimin dhe kontributin me pjesëmarrje aktive në programet e financuara nga Qeveria Gjermane **GIZ** “Shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt performancës dhe konsumatorëve” si dhe në bashkëpunim me Bashkimin Evropian në projektin për “Shërbimet e Menaxhimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura”.

Fokusi i bashkëpunimit për këtë vit me **Bankën Botërore** në kuadër të implementimit të programit për modernizimin e sektorit të ujit në Shqipëri, ka qenë mbi rezultatin e parë që pritet nga ky program, forcimi i qasjes kombëtare sa i përket politikave dhe programeve në sektorin e ujit. Për këtë arsye, përgjatë gjithë vitit 2019, ERRU ka mirëpritur në takime pune të vazhdueshme përfaqësues të Bankës Botërore për të përcjellë qëndrimet, komentet rregullatore mbi politikat fiskale, modelin e decentralizuar për ofrimin e shërbimeve, investimet financiare dhe nevoja për agregimin e shoqërive UK.

Si çdo vit, ERRU i dha rëndësinë e duhur dhe mori pjesë në mënyrë aktive me prezantime dhe moderime në konferencën dhe ekspozitën e 7-të, të përbashkët Ballkanike të organizuar nga SHUKALB dhe SHUKOS në Prishtinë me temë "Uji për të gjithë" të zhvilluar në Nëntor të vitit 2019. Konferenca iu dedikua një teme mjaft të nevojshme për ndërgjegjësimin e ruajtjes së burimeve ujore. ERRU në këtë konferencë paraqiti një prezantim mbi tematikën mjaft të ndjeshme “Përbalueshmëria si kriter bazë i Entit Rregullator të Ujit për vendosjen e çmimit të ujit”

Në vijim të bashkëpunimit me këto dy shoqata në bashkëpunim me donatorë të huaj, ERRU ka marrë pjesë në aktivitetet e zhvilluara për programin “Shërbimet këshillimore për menaxhimin e aseteve për shoqëritë UK në Evropën Juglindore” ku në fokus të tij ka qenë asistencë teknike me një program kompjuterik të avancuar dhe zgjerimi i kapaciteteve për menaxhimin e integruar të aseteve të stafit të shoqërive UK.

Në datat 15 - 17 Tetor 2019 u mbajt ngjarja më e rëndësishme diplomatike vendase e vitit, **Samiti Botëror i Ujit të Budapestit 2019**, organizuar nga Qeveria e Hungarisë, ku ERRU u përfaqësua në nivele të larta. Qëllimi i këtij samiti ishte të bashkonte vendimmarrësit politikë në botë, profesionistët e ujit dhe institucionet e financimit për të adresuar problemin global të krizës për ujë. Temat ishin të fokusuara mbi aksesin e ujit për të gjithë në kushtet e ndryshimeve klimatike, migracionit në masë si pasojë e problemeve me ujin, si dhe rolin e shkencës dhe teknologjisë në shmangien e krizave të ujit.

1.6.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së

Krahas bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, ERRU zhvillon aktivitete, seminare e takime pune me karakter bilateral bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me rregullatorë që operojnë në sektorin e ujit. Gjatë vitit 2019 në kuadër të marrëdhënieve mjaft të ngushta të bashkëpunimit ERRU zhvilloi takimin vjetor me rregullatorin e Kosovës për shkëmbimin e eksperiencës rregullatore mbi vlerësimin e investimeve në sektor në perspektivën rregullatore gjatë miratimit të tarifave dhe procesin e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve si dhe në drejtim të zhvillimit të prezantimit të seancave dëgjimore nga shoqëritë UK. Edhe në këtë takim vjetor, morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të rregullatorit të Maqedonisë (ERC), për tu njohur dhe për të ndarë eksperiencën rregullatore mbi tematikat që u zhvilluan në këtë takim.

Në Korrik 2019, ERRU zhvilloi një vizitë treditore pune dhe trajnimi pranë rregullatorit të Portugalisë, ERSAR. Duke vlerësuar rëndësinë e marrjes së një eksperience rregullatore në një nga rregullatorët më të suksesshëm në Evropë, tematikat e këtij takimi ishin të fokusuara mbi organizimin e ERSAR, karakteristikat kryesore dhe parimet e përdorura nga ERSAR në metodologjinë e vendosjes të tarifave, duke përfshirë edhe përballeshmërinë dhe tarifat sociale. Gjithashtu një vëmendje të veçantë ju dha rolit që ka ushtruar ERSAR në procesin e agregimit të sektorin të ujit në Portugali, një proces me një impakt pozitiv në sektorin e ujit si dhe faktorit të mbrojtjes së mjedisit i marrë në konsideratë gjatë procesit të përcaktimit të tarifave.

1.7 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Transparenca është një nga parimet kryesore që udhëheq ERRU-në gjatë ushtrimit të funksionit të saj rregullator në sektorin e Ujit. Së bashku me integritetin dhe llogaridhënien, ky parim na ndihmon të përcjellim të publiku besimin si dhe angazhimin tonë për përmbushjen e misionit dhe vizionit tonë.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, ERRU i ka kushtuar një vëmendje të madhe plotësimit të programit të transparencës dhe faqes zyrtare të ERRU-së në tërësi me informacionin e përditësuar duke siguruar kështu lehtësi në akses dhe informacion të gjerë për të gjithë publikun.

Gjatë vitit 2019, tre kërkesa për informacion iu drejtuan ERRU-së, të cilat u trajtuan dhe ju kthye një përgjigje zyrtare brenda afateve ligjore. Gjithashtu është punuar për përditësimin e faqes zyrtare të ERRU-së, me të gjitha vendimmarrjet e ERRU-së, publikimi i akteve nënligjore të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator si dhe statusin aktual që ka çdo shoqëri UK mbi licencën dhe tarifën e miratuara.

Komunikimi me mediat është një faktor i rëndësishëm i transparencës së rregullatorit ndaj edhe përgjatë këtij viti, ERRU, përmes intervistave dhënë në televizione të ndryshme ka përcjellë qëndrimin e saj mbi problemet dhe zhvillimet që pëson sektori i ujit.

1.8 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.8.1 Të Ardhurat

Pagesat rregullatore të operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe pagesat për licencimin e tyre përbëjnë burimin e vetëm të financimit në ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”. ERRU ka nënshkruar kontrata me operatorët për aplikimin e tarifave të miratuara, ku është përcaktuar tarifa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit. Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2019, mbështetur në kontratat me 38 shoqëri UK, është në shumën 49.208.130 lekë. Likuidimet totale në favor të ERRU të realizuara gjatë vitit 2019 janë në shumën 48.361.894 lekë, nga të cilat 48.081.894 lekë janë pagesa rregullatore dhe 280.000 lekë janë tarifa licencimi detajuar më poshtë në Tabelën 4.

Tabela 4 . Realizimi i të ardhurave sipas zërave

Nr.	Emërtimi i të Ardhurave	Vlera
1	Nga Pagesat Rregullatore të Prapambetura	25 849 848
2	Nga Pagesat Rregullatore të vitit 2019	22 232 046
3	Nga Pagesat e Licencimit	280 000
Totali		48 361 894

Për detyrimet e mbartura nga shoqëritë UK të cilat kanë një vlerë të konsiderueshme, gjatë vitit 2019 ERRU ka drejtuar kërkesa me shkrim operatorëve dhe janë realizuar aktmarrëveshje për lehtësimin e shlyerjes me këste të vazhdueshme të detyrimit të prapambetur. Gjithashtu janë në proces ekzekutimi nga zyra e përmbartimit disa shoqëri të cilat nuk kanë ekzekutuar vullnetarisht detyrimin sipas vendimit gjyqësor që janë përmendur në kapitujt e mëparshëm.

Në vijimësi KKRR ka treguar kujdes të veçantë në përcaktimin e pagesave rregullatore vjetore në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat e operatorëve që operojnë në sektorin UK.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt, si për shkak të vlerës së vogël të saj edhe si detyrim paraprak i shoqërive UK për t'u licencuar.

Likuiditetet në vitin 2019 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit për vitin 2020 të Entit, duke mbuluar tërësisht shpenzimet e parashikuara vjetore.

1.8.2 Shpenzimet Operative


Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” dhe rregullores së brendshme të ERRU “Për menaxhimin e aktiveve”.

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2019, është miratuar me VKM nr. 3, datë 09.01.2019, "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2019, për Entin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe ndryshuar me VKM nr. 337, datë 22.05.2019. Fondi i miratuar për shpenzimet operative është 50.249.000 lekë.

KKRR me vendimin e Komisionit nr. 2, datë 15.01.2019, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetore të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Plani vjetor është detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime sipas raporteve në përqindje që paraqiten në Grafikon 2, si më poshtë:




Grafiku 2. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2019

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të ERRU-së gjatë vitit 2019, janë në shumën 40.136.858 lekë, ose 80 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative.

Shpenzimet e kryera të detajuara paraqiten si më poshtë:

Pagat e punonjësve	25,754,353 lekë
Sigurime shoqërore e shëndetësore	4,117,563 lekë
Shërbime dhe furniturë	9,547,342 lekë
Investime	717,600 lekë
Totali	40,136,858 lekë

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet në formë grafike, si më poshtë:



Grafiku 3. Plani i Shpenzimeve të Miratuara nga KM krahasuar me Shpenzimet e Realizuara

Arsyeja kryesore e uljes së shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara është kursimi nga tenderimi i zërave të parashikuara në buxhetin e viti 2019, si dhe një pjesë nga pagat e Komisionerëve për periudhat e dorëheqjeve dhe emërimit të dy Komisionerëve, si dhe nga lejet e lindjeve për dy persona të stafit.

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2019

Rezoluta e Kuvendit referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit, për vitin 2018 përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2019, realizimi i të cilave cituar sipas numrit rendor, jepet si më poshtë:

1. Në kuadër të reformës, të luaj një rol aktiv dhe nxitës, në mënyrë që të bëhet i mundur realizimi i shembujve pilot të agregimit (bashkimit) të disa shoqërive UK në sektor, agregimi (bashkimi) i shoqërive do të bënte të mundur përdorimin e ekonomisë së shkallës me ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e kostove dhe lehtësi në thithjen e fondeve të BE-së për këtë sektor, në hapat e mëtejshëm të integritit të vendit.

ERRU e ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme shqetësimin për nevojën që ka sektori UK për agregimin e shoqërive, por akoma nuk ka filluar zbatimin për një projekt të tillë.

Nisur edhe nga fakti se vendi ynë është në prag të hapjes së negociatave për pranimin në Bashkimin Evropian dhe me hapjen e tyre pritet që Bashkimi Evropian të japë fonde të konsiderueshme për sektorin e ujit në përmbushje të standardeve të Direktivës së Ujit të KE, nga eksperiencia e mëparshme e vendeve pas hapjes së negociatave për në BE, përthithja e këtyre fondeve nga një **sektor i fragmentarizuar** bëhet me vështirësi, dhe në fund veprat e ndërtuara prej tyre rezultuan me kosto operimi dhe mirëmbajtje (O&M) të pajustificueshme nga ana ekonomike.

ERRU ka rekomanduar që procesi i agregimit si avantazh i ekonomisë së shkallës dhe si një nga drejtimet kryesore të përmirësimit të performancës së sektorit duhet të realizohet sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”. Në praktikë kjo duhet filluar që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme. Realizimi me sukses do të shërbejë si shembull bëshmërie i realizimit me sukses i strategjisë së sektorit për t'u zhvilluar në shkallë të gjerë në periudhën afatmesme.

ERRU gjatë gjithë vitit ka vazhduar të insistojë me përfaqësuesit e lartë përgjegjës të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të iniciuar një proces të tillë, veçanërisht në mbledhjen e Grupit të Punës për hartimin e Ligjit të Sektorit UK, përkundrejt qasjes së propozuar nga konsulencia që agregimi të realizohet me anë të Strukturave të Subjekteve të Përbashkëta dhe në mënyrë detyruese. Kjo përjasje mbart në vetvete paqartësi në realizimin praktik dhe ligjor të qasjes. I njëjti shqetësim theksohet edhe njëherë në Raportin Vjetor të Performancës së Sektorit UK për Vitin 2018 hartuar dhe publikuar nga ERRU. ERRU është gjithnjë e gatshme për të dhënë kontributin e saj në këtë fushë sidomos për hartimin e modeleve financiare të rasteve të agregimit dhe me tarifat e pritshme orientuese përkatëse.

Gjithashtu ERRU edhe në takimet me donatorët si Banka Botërore, GIZ, KfW ka diskutuar mbi domosdoshmërinë e fillimit të procesit të agregimit dhe të merret në konsideratë në planet e asistencës së tyre në të ardhmen e afërt. Gjithsesi ky proces duhet të iniciohet dhe udhëhiqet nga institucionet tona qendrore dhe lokale përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, por që akoma nuk po shihen hapa konkrete në këtë fushë.

2. Me gjithë tendencën e lehtë rënësë të 3 viteve të fundit të “Ujit Pa të Ardhura”, ky treqes vijon të mbetet në shifra tepër të larta, ndaj ERRU, përmes politikave të tarifimit, të ushtrojë presion mbi shoqëritë UK, duke kërkuar nga shoqëritë UK plane veprimi të detajuara konkrete dhe të matshme për përmirësimin e këtij treqesi shumë të rëndësishëm.

Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK në sektor.

ERRU në fund të çdo analize që i bën aplikimeve për tarifa i jep një rëndësi të veçantë vendosjes së objektivit mbi treguesin e Ujit Pa të Ardhura shoqëruar edhe masat që shoqëria duhet të ndërmarrë për reduktimin e tij. Kjo lidhet kryesisht me saktësimin e të dhënave për prodhimin e ujit si dhe vlerësimin dhe masat që duhen marrë për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike, si për lidhjet e paligjshme, nën faturime edhe për abuzimet e ndryshme për ujitje etj. Gjatë vitit 2019, ERRU ka analizuar dhe aprovuar tarifa për shoqëritë duke vendosur objektiva për reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, si më poshtë në tabelën 5:

Tabela 5. Treguesi i Ujit Pa të Ardhura

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2018 (në %)	Propozimi i shoqërisë (në %)	Objektivi i vendosur nga ERRU (në %)
1	UK Gjirokastër	56	49.3	49.3
2	UK Poliçan	46	32.6	32.6
3	UK Delvinë	48	52.5	47
4	UK Tropojë	61	64	58
5	UK Lushnje	75	70.6	70.6
6	UK Berat - Kuçovë	77	76	74
7	UK Krujë	55.9	55.1	52
8	UK Vlorë	77.1	75.9	73
9	UK Himarë	74	67	67
10	UK Roskovec	67.5	62.3	60
11	UK Malësi e Madhe	57*	-	-
12	UK Vore	68	66	66

* Kjo shoqëri në vitin 2019 ka aplikuar për tarifë vetëm për shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Treguesi në tabelë i UPA i përket vitit 2018, ndërkohë që si objektivi UPA ka qenë 62% vendosur kur shoqëria ka aplikuar për shërbimet e furnizimit me ujë në vitin 2017.

Nga tabela shihet që objektivat për uljen e Ujit Pa të Ardhura, që në fakt i përkasin vitit 2020, nuk duken mjaft ambicioze. ERRU në vendosjen e tyre ka patur parasysh influencën e performancës së mëparshme realizuar në uljen e këtij treguesi për pjesën e humbjeve administrative nga lidhjet e paligjshme përgjatë zbatimit të aksionit të reformës së ujit kundër informalitetit. Ndërkohë akoma ndihet mungesa e investimeve fizike në këto shoqëri që do të mundësonin uljen e komponentit të humbjeve fizike në treguesin e Ujit Pa të Ardhura.

Nga ana tjetër gjatë vitit 2019 ERRU ka hartuar një raport mjaft të rëndësishëm për Bilancin e Ujit në sektor ku trajtohen individualisht dhe në tërësi problemi i Ujit Pa të Ardhura dhe me rekomandimet përkatëse. ERRU vazhdon të rrisë kërkesën dhe asiston Shoqëritë UK për të hartuar një Bilanc Uji sa real dhe të detajuar dhe progresi në këtë drejtim është i dukshëm. Gjithsesi përmirësimi i këtij treguesi mbetet një nga prioritetet kryesore të punës së ERRU-së gjatë analizës dhe monitorimit të performancës së shoqërive UK, veçanërisht kur ato aplikojnë për tarifa të reja.

3. Të kërkojë nga shoqëritë UK argumentim të plotë e të saktë mbi numrin e punonjësve dhe përshkrimin e detajuar të punës për secilin pozicion të stafit të saj dhe njëkohësisht të nxisë një përdorim më të madh të teknologjisë në sektorin UK, në mënyrë të veçantë për të bërë të mundur

zëvendësimin e shërbimit të sigurisë fizike përmes sistemeve monitoruese CCTV, që e cila ndikon në rritjen e efikasitetit të stafit, treqes i cili, me gjithë përmirësimin e lehtë, vijon të mbetet i lartë.

ERRU gjatë procesit të analizës tekniko - ekonomike të shoqërive që kanë aplikuar për nivel të ri tarifor e analizon si treguesin staf për 1000 lidhje ashtu dhe kostot e punës të lidhura me të. ERRU u kërkon shoqërive të paraqesin organogramën e stafit me pozicionet e punës dhe pagat respektive me argumentet përkatëse.

Është i njohur fakti që shoqëritë UK janë të mbingarkuara me staf të punësuar në kritere jashtë nevojave reale dhe profesionalizimit të stimuluar nga politika. Në këtë kuadër gjatë këtij viti, ERRU **ka refuzuar kostot shtesë për stafin e shoqërisë UK Lushnje** gjatë aprovimit të tarifave të propozuara nga kjo shoqëri. ERRU vazhdon ti kushtojë rëndësi të veçantë analizës së këtij zëri të veçantë të kostos duke i kërkuar informacion të hollësishëm shoqërive për justifikimin e numrit të punonjësve, të pozicioneve të tyre dhe në funksion të ngarkesës që ato duhet të përballojnë për operimin e Shoqërisë në ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve konsumatorëve.

Arsye tjetër e rritjes artificiale të numrit të punonjësve është garantimi i sigurisë së objekteve të sistemeve të furnizimit me ujë me roje. Vihet re që kostot e shërbimit nga nënkontraktorët rezultojnë përgjithësisht të rritura në shoqëritë që kanë lidhur kontrata shërbimi për ruajtjen e objekteve krahasuar me kostot kur ky shërbim kryhej nga punonjësit e vet shoqërisë. ERRU vazhdimisht i ka rekomanduar shoqëritë që të kryejnë shërbimin e ruajtjes së objekteve nëpërmjet sistemeve monitoruese në distancë, por aktualisht asnjë shoqëri nuk e realizon. Garantimi i monitorimit të sigurisë së objekteve me kamera sigurie kërkon fonde shtesë që shumë prej shoqërive nuk mund t'i përballojnë financiarisht.

Për realizimin e saj ERRU ka propozuar që të alokohen dhe prokurohen fonde nën përgjegjësinë e Agjencisë Kombëtare të Ujit dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM). Ky rekomandim theksohet edhe në Raportin Vjetor të Performancës së Sektorit UK për Vitin 2018 hartuar dhe publikuar nga ERRU.

4. *ERRU, nga njëra anë, të nxisë shoqëritë UK që të marrin masa për instalimin e matësve në burim dhe nga ana tjetër, të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së mbetjeve (AKUM) për implementimin e planit të punës për pajisjen e të gjitha shoqërive me ujëmatës të mëdhenj.*

ERRU në të gjitha raportet dhe analizat që publikon për shoqëritë UK, nisur edhe nga nivelet e larta të Ujit Pa të Ardhura ka rekomanduar dhe nxitur në mënyrë të vazhdueshme shoqëritë që të instalojnë matës si në burim ashtu edhe në pikat e konsumit në mënyrë që të kenë vlera të sakta të sasisë së ujit të prodhuar. Në të gjitha raste e aplikimeve për tarifa të reja ERRU vendos objektiva ambicioze në drejtim të rritjes së përqindjes së konsumatorëve të pajisura me ujëmatës

Qeveria Qendrore në kuadrin e reformës në sektor ka marrë përsipër financimin dhe prokurimin e ujëmatësve të mëdhenj për të gjithë shoqëritë UK, me prioritet shoqëritë e vogla dhe të mesme që kanë mundësi financiare të kufizuara. Ky aksion si prioritet i sektorit në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë po ndiqet dhe zbatohet nga AKUM.

5. *ERRU, përmes të gjitha instrumenteve ligjore që disponon, të kërkojë nga shoqëritë UK rritjen e normës së arkëtimit, si një treqes i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK.*

ERRU e konsideron të rëndësishëm përmirësimin e nivelit të treguesit “Norma e Arkëtimit” pasi lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare si dhe aftësinë paguese të shoqërive UK. Si rrjedhojë gjatë aplikimit të shoqërive për nivel të ri tarifor, përmirësimi i Normës së Arkëtimit është një ndër objektivat kryesorë që ERRU i vendos shoqërive për të arritur në të ardhmen (shih Tabelën 6)

Në kuadër edhe të reformës së ujit ashtu si në vitin 2018 edhe gjatë vitit 2019, shoqëritë po punojnë me plane konkrete për arkëtimin e detyrimeve që kanë klientët për shërbimet UK dhe sidomos të detyrimeve të prapambetura.

Për të vlerësuar performancën reale të shoqërive në drejtim të Normës së Arkëtimit, ERRU i kërkon shoqërive UK që të raportojnë veç Normën Korrente të Arkëtimit (NKA) dhe veç Normën e Përgjithshme të Arkëtimit (NPA) që përfshin dhe mbledhjen e debive të prapambetura.

ERRU e vendos theksin sidomos në treguesin NKA i cili tregon performancën e qëndrueshme të shoqërisë për vlerat që ajo i faturon klientëve, tregues i cili është pjesë e objektivave që ERRU vendos gjatë analizës dhe aprovimit të tarifave të reja për shoqëritë.

Natyrisht vlerësohet edhe treguesi NPA ku ka përparime të dukshme si rezultat i Akt-Marrëveshjeve kohore të arsyeshme që shoqëritë UK lidhin me klientët me qëllim shlyerjen pjesë-pjesë të debive të prapambetura krahas pagesës së faturës korrente. Më poshtë jepet një situatë e shoqërive që u janë miratuar tarifa gjatë vitit 2019 në lidhje me objektivin e përcaktuar nga ERRU për NKA si dhe realizimin nga ana e tyre.

Tabela 6. Treguesi i Normës së Arkëtimit Korrente (NKA)

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2019 (në %)	Propozimi i shoqërisë (në %)	Objektivi i Vendosur nga ERRU (në %)
1	UK Gjirokastrë	75	82	87.7
2	UK Poliçan	79	88.4	88.4
3	UK Delvinë	78	82	82
4	UK Tropojë	64	71	75
5	UK Lushnje	81	85	85
6	UK Berat - Kuçovë	83	87	87
7	UK Krujë	71.9	75.4	77
8	UK Vlorë	63	72	72
9	UK Himarë	72	80	80
10	UK Vorë	79	83	83
11	UK Roskovec	69	80	80
12	Malësi e Madhe	70.5	68	68

Të dhënat e tabelës 6 për Shoqëritë që kanë aplikuar për tarifa të reja pranë ERRU-së tregojnë përgjithësisht një progres të dukshëm edhe ndaj objektivave të vendosura prej saj. ERRU do të vazhdojë të vejë theksin në të ardhmen për përmirësimin e këtij treguesi bazuar në një analizë të thelluar dhe duke vendosur gjithnjë e më shumë objektiva agresive për tu realizuar nga Shoqëritë UK.

6. Në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e një zqijdhjeje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve, të miratohet “Rregulloren për trajtimin e ankesave të konsumatorëve”, e cila ishte e përfshirë në objektivat dhe rekomandimet e vitit 2018.

Në vijim të objektivave dhe rekomandimeve të dhëna dhe në përfundim të procesit të këshillimit publik, Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr.18, datë 19.04.2019 ka miratuar rregulloren "Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar".

7. ERRU, në kuadër të mbrojtës së konsumatorit, të ketë gjithmonë në konsideratë faktorin e përballueshmërisë në aprovimin e tarifave.

Kriteri i përballueshmërisë është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e tarifave për shërbimet UK të shoqërive. Nisur nga informacioni që publikon INSTAT në lidhje me shpenzimet mesatare mujore për familje në rang qarku, ERRU konsideron si kufi maksimal të përballueshmërisë nivelin 5% të shpenzimeve mesatare për familje. Për verifikimin e kriterit të Përballueshmërisë ERRU merr si referim faturën e një familje me 4 persona faturuar me matje për një normë konsumi mesatare 100 litra/ditë/banor. Në asnjë rast ky nivel nuk është tejkaluar. Për shoqëritë të cilat ERRU ka analizuar dhe aprovuar tarifën gjatë vitit 2019, kriteri i përballueshmërisë është plotësuar si më poshtë:

Tabela 7 Përballueshmëria

Nr.	Operatori		Shpenzime Mesatare Mujore Familjare sipas Qarqeve (në lek)*	Kufiri i Përballueshmërisë së Shpenzimeve Mesatare Mujore Familjare (në lek)	Fatura Mesatare me Matje për 4 Persona (në Lek)
1	Sh.a UK Gjirokastrë	Gjirokastrë	62,237	3,112 (5%)	941 (1,51%)
		Njësitë Administrative			456 (0,73%)
2	Sh.a UK Poliçan		69,948	3,497 (5%)	641 (0,92%)
3	Sh.a UK Delvinë		58,374	2,919 (5%)	930 (1,6%)
4	Sh.a UK Tropojë	Bajram Curri	66,218	3,311 (5%)	883 (1,33%)
		Njësitë Administrative			552 (0,83%)
5	Sh.a UK Lushnje	Lushnje	71,052	3,553 (5%)	1,044 (1,47%)
		Njësitë Administrative			840 (1,18%)
6	UK Berat - Kuçovë	Berat – Kuçovë	69 948	3497 (5%)	965 (1,38%)
		Njësitë Administrative			833 (1,19%)
7	UK Krujë	Krujë, Fushë-Krujë	75 744	3787 (5%)	739 (0,98%)
8	UK Vlorë	Vlorë dhe Njësitë Administrative	68 227	3411 (5%)	984 (1,44%)
9	UK Himarë		68 227	3411 (5%)	1464 (2,15%)
10	UK Vorë		88 691	3411 (5%)	1392 (1,57%)
11	UK Roskovec		71 117	3556 (5%)	1145 (1,61%)

* Informacioni është marrë nga INSTAT Anketa e Buxhetit të Familjes, 2017. INSTAT nuk ka nxjerrë të shprehur në decila të dhëna për vitin 2018.

Verifikimi i kriterit të Përballueshmërisë tregon që shoqëritë kanë akoma mjaft hapësirë për rritjen e tarifave të ujit për të përballuar kostot e O&M dhe ato kapitale, por ERRU në këto analiza krahas kriterit të mbulimit të kostove ka parasysh gjithashtu që një rritje drastike e tarifave sjell edhe efekte negative financiare për shkak të uljes së normës së arkëtimit nga reagimi i konsumatorëve ndaj kësaj rritje të menjëhershme të tarifës.

8. Të rrisë përpjekjet për promovimin e institucionit përmes mjeteve të informimit publik, si dhe mediave sociale, për të bërë të mundur ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre dhe rolin e ERRU-së për mbrojtjen e interesave të konsumatorit.

Gjatë vitit 2019, Enti Rregullator i Ujit nëpërmjet faqes zyrtare të website erru.al ka vijuar përpjekjet të përcjellë në mënyrë transparente dhe periodike informacionin e nevojshëm mbi rolin e rregullatorit dhe punën që kryhet në kuadër të rregullimit të sektorit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Në të publikohen të gjitha raportet e aktivitetit vjetor të ERRU-së, Raportet Vjetore të Performancës së Sektorit Ujësjellës Kanalizime, si dhe të gjitha vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator. Konsumatorët në faqen e website të ERRU-së gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm tekniko-ekonomik dhe legjislativ për gjendjen e sektorit, si dhe atë informacion që i ndërgjegjëson për të drejtat e tyre, si dhe për rolin e Rregullatorit në mbrojtje të interesave të tyre. Në kuadër të ndërgjegjësimin të konsumatorëve për të drejtat e tyre në sektorin e ujit, ERRU gjithashtu gjatë këtij viti ka marrë pjesë aktive në Workshope me prezantime mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit për shërbimet e furnizimit me ujë pranë Qendrës së Konsumatorit Shqiptar.

Pjesë e promovimit është dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve në numër gjithnjë në rritje që tregon rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve ndaj institucionit të ERRU-së. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar 18 ankesa, ku megjithëse roli i ERRU-së për trajtimin e tyre nuk është vendimmarrës, 6 prej tyre janë zgjidhur në favor të konsumatorëve.

9. ERRU të vlerësojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri rekomandimet e bëra nga institucionet e tjera lidhur me vendimmarrjen e ERRU-së apo me sektorin e UK, në mënyrë të veçantë nga Autoriteti i Konkurrencës, me të cilin ka tashmë edhe një Memorandum Mirëkuptimi.

Në vijim të nënshkrimit dypalësh të Memorandum Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës në vitin 2018, ERRU edhe gjatë vitit 2019 ka intensifikuar bashkëpunimin dhe marrëdhëniet dy palëshe me Autoritetin e Konkurrencës.

ERRU ka raporte bashkëpunimi mjaft të mira me Autoritetin e Konkurrencës, dhe në zbatim të akteve ligjore ka dërguar sistematikisht pranë Autoritetit të Konkurrencës të gjitha projekt aktet me dokumentet shoqëruese për miratimin e tarifave me qëllim vlerësimin në lidhje me mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjes së interesave publike. Kjo është pjesë e strategjisë së krijimit të një mjedisi transparent ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Të gjitha rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me vendimet për tarifën e propozuara nga shoqëritë **UK Poliçan, Delvinë, Tropojë, Lushnje, Gjirokastër, Berat-Kuçovë, Krullë, Vlorë, Himarë, Vorë, Roskovec dhe Malësi e Madhe** analizuar dhe aprovuar nga ERRU gjatë vitit 2019, i janë përcjellë zyrtarisht këtyre të fundit.

10. Të finalizojë dhe të miratojë sa më parë “Metodologjinë e vendosjes së tarifave” duke iu referuar edhe eksperiencave më të mira ndërkombëtare nga konsultimi me Shoqatën e Rregullatorëve të Evropës WAREG, kjo metodologji ishte e përfshirë në objektivat dhe rekomandimet e vitit 2018.

ERRU ka konkluduar në draftin final të rishikimit të Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave me synim përmirësimin e saj me ndryshimet që kanë ndodhur në sektor. Krahas përmirësimeve të aktit ekzistues, në parim rishikimi i metodologjisë konsiston në marrjen parasysh që në të ardhmen e afërt shoqëritë do të aplikojnë për tarifa të reja që do të mbulojnë përveç kostove të O&M, edhe ato të investimeve kapitale në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Bazuar në analizën e performancës aktuale, shoqëritë që priten në të ardhmen e afërt të aplikojnë për tarifa që do të mbulojnë edhe kostot pjesore/totale të investimeve pa cenuar kriterin e përballeshmërisë janë, përkatësisht shoqëritë **Tiranë, Korçë, Lezhë, Berat-Kuçovë, Kolonjë dhe Kamëz.**

Nisur nga rëndësia që ka ky dokument për punën e ERRU-së në përgjithësi dhe për sektorin UK në tërësi, ERRU është bazuar edhe në eksperiencat e metodologjisë së Rregullatorëve Evropian (WAREG). Në këtë drejtim, ERRU ka zhvilluar Workshope me rregullatorët e Italisë, Skocisë, Portugalisë dhe së fundmi është duke bashkëpunuar ngushtësisht me rregullatorin e Bullgarisë me qëllim që të arrihet në një dokument të metodologjisë së tarifave sa më efikas dhe të vlefshëm i cili të përshtatet me nevojat e sektorit në kohë.

Metodologjia e re do të konceptohet në dy nënmodele, përkatësisht për rastin kur shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve kërkojnë të mbulojnë vetëm Kostot e Operim Mirëmbajtjes (O&M), si dhe rastit kur ato kërkojnë të mbulojnë edhe kostot e investimeve fizike të nevojshme në sisteme që kërkon domosdoshmërisht të kenë një Plan Biznesi 5 Vjeçar të aprovuar.

Ky dokument ishte parashikuar të finalizohet në fund të vitit 2019, por si rezultat i ndryshimeve ligjore që pritet të ndodhin së shpejti për ligjin e ri të sektorit të ujit i cili prek edhe ligjin nr. 8102 të ERRU, miratimi i këtij dokumenti lihet pas miratimit të ligjit të ri për sektorin në mënyrë që të bëhet përshtatja e tij me termat dhe referencat që do të kërkojë ligji i ri.

11. Të marrë pjesë aktive, me propozime konkrete, dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorët e tjerë për hartimin e ndryshimeve ligjore, të cilat, megjithëse të vonuara, pritet të sjellin një përcaktim më të qartë të statusit ligjor të ERRU-së, si dhe një dimension të ri lidhur me rolin e tij si institucion i pavarur në sektorin UK

ERRU ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë aktorët në sektor sa i takon ndryshimeve ligjore, veçanërisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në vijim të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor 2018, ERRU në Prill të vitit 2019 ka përcjellë pranë grupit ndërinstitucional të punës ngritur me urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 581, datë 18.07.2018, komentet dhe qëndrimin e tij mbi draftin e ligjit për sektorin ujësjellës kanalizime.

ERRU ka parashtruar vazhdimisht rezerva në mbledhjet e Grupit të Punës për ligjin e sektorit UK pasi Drafti i paraqitur është konceptuar që në të të përfshihen përveç ligjit aktual nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, edhe nën akte të karakterit teknik dhe në ndryshim të vazhdueshëm, si Kodi i Ujit, Marrëveshja Shoqëri UK - Konsumator etj. Një strukturë e tillë do ta bënte këtë ligj mjaft të rënduar dhe të vështirë që t’i përgjigjet dinamikës së kërkesave në evoluim të vazhdueshëm të nën-akteve të karakterit teknik që mendohet të përfshihen në të. Nga ana tjetër ERRU mendon që ligji 8102 për ERRU-në është ligj që rregullon sektorin e UK. Në këtë kuadër ERRU ka paraqitur pranë Grupit të

Punës ndryshimet që propozohen për këtë ligj. Përfundimisht është e nevojshme që të rishikohet vetëm ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si akt ligjor që rregullon sektorin UK i cili duhet të qëndrojë më vete. Më tej të rishikohen më vete si nën-akte sidomos Kodi i Ujit që me të vërtetë është një kërkesë e evidente që ka aktualisht sektori.

Këto janë rekomandime që jepen bazuar në eksperiencën dhe njohuritë për sektorin nga një institucion ligj zbatues si ERRU, por që nuk pretendohet se nëpërmjet tyre është e vetmja rrugë për rritjen e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve. Kontaktet dhe diskutimet e vazhdueshme me Ministrinë e linjës (MIE) tregojnë që synohet një qasje disi e ndryshme nga rekomandimet e mësipërme që mishërohet në projekt-ligjin e sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.

Gjithsesi ERRU në lidhje me konceptin e ligjit për sektorin UK i qëndron rekomandimeve të dhëna prej saj në Grupin e Punës, pra që nuk duhet një ligj integral për sektorin. Aktet dhe nën aktet ligjore aktuale të qëndrojnë, ndërkohë që disa prej tyre kanë nevojë të rishikohen, si ligji 8120 për rregullatorin, Kodi i Ujit, nën aktet për Akt Miratimin Higjieno Sanitar etj.

Elementet e nevojshme ligjore për zbatimin e qasjes së re (Operatori i Alternativës së Fundit, Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta) mund të zgjidhen me anë të një vendimi të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Theksohet fakti që ERRU e ka përmbushur këtë detyrim të Rezolutës së Kuvendit që në vitin që kaloi, por formalizimi i tij është ndërprerë për shkak të ndryshimit të procesit për hartimin e një ligji për sektorin, siç u shpjegua më sipër.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

Një pjesë shumë të rëndësishme në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së zë edhe pjesa e Rekomandimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë nga qeveria qendrore për përmirësimin e performancës së sektorit të ujit. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin e mëparshëm 2018, të dërguar pranë Këshillit të Ministrave dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë nga Kryetari i këtij institucioni si dhe në raportin e performancës për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të vitit 2018, janë dhënë disa rekomandime të cilat kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrjen dhe mbështetjen e qeverisë qendrore.

Rekomandimet e dhëna nga ERRU në vitin 2018 konsistojnë kryesisht në disa pika konkrete të nevojshme për t'u ndërmarrë në konsideratë nga qeveria qendrore për përmirësimin e sektorit UK në vendin tonë të cilat ishin :

- Në kontratat e reja të performancës përveç AKUM të përfshihet edhe ERRU në procesin e vlerësimit të treguesve të performancës, dhe në përcaktimin e objektivave për shoqëritë në të ardhmen.
- Paralelisht me procesin e mësipërm duhet të punohet për nisjen e procesit të agregimit si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit "në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore" duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme aty ku

shihet më i mundshëm sukcesi, pasi sektori paraqitet mjaft i fragmentarizuar. Strategjia e agregimit të sektorit duhet të orientohet kryesisht në grupin e shoqërive të dimensionit të mesëm, rast pas rasti dhe jo në bllok. Për këtë duhet të mundësohet një anketë në të gjitha bashkitë e vendit ku të përcaktohen vendet e mundshme të suksesshme për agregim. ERRU duhet të paravlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.

- Të vazhdojë puna për hartimin e akteve të nevojshme nënligjore për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të Inspektimeve Higjeno Sanitare në elementët e sistemeve të furnizimit me ujë.
- Të rivlerësohet situata për konceptimin e ligjit të ri të sektorit UK si një ligj ku presupozohet përfshirja në një dokument të vetëm e gjithë legjislacionit aktual dhe nënakteve të tij, që e bën atë mjaft të rënduar për t'ju përgjigjur dinamizmit që kërkojnë mjaft pjesë të tij. Rekomandohet mbajtja e tij në kornizat e ligjit aktual nr. 8102 për rregullimin e sektorit i propozuar për t'u rishikuar dhe të trajtohen si nënakte më vete Kodi i Ujit (ka nevojë urgjente për tu rishikuar), si dhe legjislacioni për Akt Miratimin Higjeno Sanitar që lëshon Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, i cili ka mjaft mangësi praktike për realizimin e tij.
- Duke pasur parasysh deficitin financiar të operimit të sektorit UK dhe nevojës për subvencione, për shëndoshjen financiare të sektorit vëmendja kryesore duhet fokusuar në problematikat individuale të shoqërive, duke analizuar performancën e tyre, mundësitë për përmirësim e në fund në orientimin e drejtë të subvencioneve deri sa shoqëritë të bëhen të qëndrueshme nga ana financiare.
- Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK. Shoqëritë duhet të nxiten dhe të mbështeten nga qeveria qendrore që të instalojnë matës si në burim ashtu edhe në pikat e konsumit në mënyrë që të hartohen bilance të sakta të ujit, si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi tyre si një prerogativë ligjore kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja. AKUM të vlerësojë nevojat dhe të incitativë financimin e hartimit të tyre nga qeveria qendrore dhe donatorët për shoqëritë që kanë mundësi financiare të kufizuara.
- Të analizohen thellësisht elementët bazë të qasjes së re si strategji për përmirësimin e performancës së sektorit në aspektet praktikore ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta.
- ERRU rekomandohet të përfshihet në procesin e përcaktimit të prioriteteve të investimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, si dhe në aprovimin e tyre bazuar në kritere tekniko ekonomike.
- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.

Këto janë rekomandime që jepen bazuar në eksperiencën dhe njohuritë për sektorin nga një institucion ligj zbatues si ERRU, por që nuk pretendohet se nëpërmjet tyre është e vetmja rrugë për rritjen e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve. Kontaktet dhe diskutimet e

vazhdueshme me Ministrinë e linjës (MIE) tregojnë që synohet një qasje disi e ndryshme nga rekomandimet e mësipërme që mishërohet në projekt-ligjin e sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve.

Gjithsesi ERRU në lidhje me konceptin e ligjit për sektorin UK i qëndron rekomandimeve të dhëna prej saj në Grupin e Punës, pra që nuk duhet një ligj integral për sektorin. Aktet dhe nën aktet ligjore aktuale të qëndrojnë, ndërkohë që disa prej tyre kanë nevojë të rishikohen, si ligji Nr. 8120 për Rregullatorin (që në fakt ky është ligji që rregullon sektorin), Kodi i Ujësjetës Kanalizimeve, nën aktet për Akt Miratimin Higjieno Sanitar etj.

Elementet e nevojshme ligjore për zbatimin e qasjes së re (Operatori i Alternatives së Fundit, Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta) mund të zgjidhen me anë të një vendimi të veçantë të Këshillit të Ministrave.

4 Gjendja në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime

4.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2019

Gjendja e Sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve e paraqitur në këtë raport bazohet në të dhënat tekniko ekonomike vjetore të Shoqërive UK që raportojnë direkt pranë ERRU-së bazuar në platformën e data bazë të instaluar gjatë vitit 2019. Theksohet fakti që ky raport hartohet për herë të parë me të dhënat e veta të ERRU-së në ndryshim me praktikën e viteve të tjera, ku raporti bazohej në të dhënat 9 mujore të Shoqërive UK të raportuara në AKUM duke i ekstrapoluar ato për periudhën 12 mujore (vjetore). Është i njohur fakti që ekstrapolimi i të dhënave nga 9 në 12 mujore përmban në vetvete pasaktësi të mëdha që mund të çojnë në konkluzione të gabuara për gjendjen e performancës së sektorit.

Në fakt të dhënat ekonomiko-financiare të raportuara nga Shoqëritë nuk janë të certifikuara nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, proces i cili mbaron zakonisht deri në fund të muajit mars 2020, por procedimi si më sipër garanton një saktësi mjaft më të madhe se metoda e mëparshme me ekstrapolim.

Kjo papërshtatshmëri dhe vështirësi për hartimin e pjesës së raportit që lidhet me gjendjen e performancës së sektorit, vjen nga kushti i shprehur në ligjin nr. 8102 që raportimi mbi aktivitetin e ERRU-së dhe të gjendjes së performancës së sektorit duhet të jetë hartuar (botuar në hard copy) deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës.

Analiza e plotë e sektorit të ujit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie në veçanti jepet në Raportin Vjetor të Performancës që hartohet dhe botohet nga ERRU në fund të Qershorit të vitit pasardhës pasi disponohen të dhëna të plota vjetore të certifikuara për shoqëritë UK pas mbylljes së pasqyrave financiare në 31 mars 2020.

ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e secilit operator dhe të sektorit në tërësi për shërbimet e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos të atyre shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU vitet e fundit. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR. Tabela 8 jep nivelet e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2019 dhe tendencën e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2018.

Tabela 8. Treguesit Kryesorë të Performancës

Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2018	Viti 2019	Tendenca
Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	77	77.2	↗
Mbulimi me Kanalizime	%	52	52.9	↗
Mbulimi i Kostove O&M	%	119	108.3	↘
Norma e Arkëtimit Korrente	%	79	79	=
Niveli i Matjes	%	74	77.5	↗
Ujë Pa të Ardhura	%	63	63	=
Efiçenca e stafit	(stafi/1000lidhje UK)	5.35	5.31	↗
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	12.7	13.2	↗

Burimi : ERRU

Sektori UK është në përfundim të riorganizimit sipas Reformës Territoriale. Në fund të vitit 2019 nga 57 shoqëritë UK, 49 prej tyre raportojnë të dhëna sipas zonave të reja të shërbimit në përputhje me kufijtë administrativë të bashkive që ato ofrojnë shërbimet e ujësjellës kanalizimeve. Siç u theksua në kapitujt e mëparshëm mbesin akoma 8 shoqëri të pa licencuara nga ERRU për shkak të problematikave ligjore në drejtim të vlerësimit, transferimit të aseteve, regjistrimit të tyre në QKB, si dhe të mos marrjes së Akt Miratimit Higjeno Sanitar nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Nga Tabela 8 përmbledhëse e Treguesve Kryesorë të Performancës **vërehet se gjendja në sektor në krahasim me vitin 2018 paraqet një përkeqësim në drejtim të mbulimit të kostove direkte të O&M. Ndërkohë që treguesit e Ujit Pa të Ardhura dhe të Normës së Arkëtimit Korrente mbesin në nivele të pandryshuara. Kjo tregon se në sektor janë rritur kostot për O&M, ndërkohë që të ardhurat kanë mbetur në nivele pothuajse të njëjta.**

Në detaje për Treguesit Kryesorë të Performancës konstatohet si më poshtë:

"Mbulimi me Furnizimin me Ujë" për vitin 2019 është pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin paraardhës. Sipas raportimeve, popullsia në Juridiksion është rritur me 232.621 banorë ndërsa ajo e shërbyer me 159,339 banorë. Ku ndryshim i shifrave krahasuar me vitin 2018 ka ardhur nga fakti se shoqëritë kanë saktësuar të dhënat mbi numrin e popullsisë sipas regjistrave të gjëndjes civile dhe të numrit të lidhjeve që i shërben shoqëria. Duhet theksuar fakti se zgjerimi zonës së shërbimit të shoqërive me zonat e bardha ose të pa shërbyera më parë influencon në përkeqësimin "artificial" të treguesve të performancës për shoqërinë, zona të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme fizike për tu reflektuar në përmirësimin e treguesve të performancës së shoqërisë në tërësi.

"Mbulimi me Kanalizime" është rritur me rreth 1% krahasuar me vitin 2018 duke shënuar nivelin 52.9%. Popullsia e shërbyer është rritur me 152 850 banorë kundrejt popullsisë në juridiksion që është rritur me 232 621 banorë. Ndikim në rritje të popullsisë së shërbyer dhe të numrit të klientëve me kanalizime kanë dhënë investimet e kryera nga buxheti i shtetit. Ndërkohë krahas 647,732 lidhjeve që përfitojnë shërbimin e kanalizimeve raportohen edhe 54,323 lidhje që e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike.

Sigurisht që përmirësimi në të ardhmen i këtij treguesi (shërbimi) kërkon domosdoshmërisht ndërhyrjen me investime, vëmendja e të cilës realisht deri më tani ka qenë e fokusuar kryesisht në

drejtim të furnizimit me ujë të pijshëm pasi edhe efekti në popullatë është më i ndjeshëm tek ky shërbim.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes"

Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes është treguesi që shpreh mbulimin me të ardhura të kostove për personelin, energjinë, kimikate, qera, karburantin, shërbime të kontraktuara dhe kosto të tjera që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen. Në total për sektorin ky tregues paraqitet i qëndrueshëm financiarisht megjithëse është ulur nga 119% në 108.3%. Megjithatë duke analizuar në detaje çdo shoqëri, sektori paraqitet me probleme mjaft të mëdha në drejtim të performancës financiare. Nga totali prej 57 shoqëri UK në sektor, 13 prej tyre arrijnë të mbulojnë mbi 100% koston O&M, 27 shoqëri që performojnë dobët në nivelin nën 70% të tyre që do të thotë me vështirësi mbulojnë koston e punës. Pjesa tjetër e shoqërive janë në nivelet 71% deri 100% të këtij treguesi. Ndërkohë vetëm 4 shoqëri arrijnë të mbulojnë Kostot Totale. Për vitin 2019, i gjithë sektori rezulton me mbulim të kostove të O&M mbi 100% sepse impaktin pozitiv më të madh e jep UK Tirana që këtë tregues e ka 162% dhe përbën gati 1/3 e të gjithë klientëve të sektorit.

Në detaje koston për sektorin e Ujësjetës kanalizimeve jepen në Tabelën 9

Tabela 9. Ecuria e Kostove dhe të Ardhurave krahasuar me vitin paraardhës

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Diferenca
	<i>Kostot e Shërbimit UK</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>
1	Kosto e punës	3,760,301	4,276,771	+516,470
2	Kosto e materialeve	216,069	559,361	+343,292
3	Kosto e energjisë së konsumuar	2,365,574	2,652,819	+287,245
4	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	545,576	557,494	+11,918
5	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	779,886	831,759	+51,873
7	Kosto të tjera operacionale	559,484	708,094	+148,610
8	Kosto të tjera			
	<i>Kostot Operim & Mirëmbajtjes</i>	<i>8,226,890</i>	<i>9,586,298</i>	<i>+1,359,408</i>
	Kostot e amortizimit	1,897,345	2,472,716	+575,371
	Kostot financiare taksa tatime	556,886	610,561	+53,675
	<i>Kostot Totale</i>	<i>10,680,121</i>	<i>12,669,574</i>	<i>1,988,454</i>
	<i>Të Ardhurat nga Aktiviteti</i>			
1	Të ardhurat nga faturimi UK dhe të ardhura të tjera të aktivitetit	9,799,217	10,383,241	+584,024
	<i>Të Ardhurat Totale</i>	<i>9,799,217</i>	<i>10,383,241</i>	<i>+584,024</i>
	<i>Niveli i Mbulimit të Kostove</i>			
	Mbulimi i Kostove të O & M	<i>119%</i>	<i>108.3%</i>	

Nga Tabela e mësipërme vërehet se Sektori për vitin 2019 e ka zhvilluar aktivitetin e tij duke shënuar një rritje të konsiderueshme të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes me rreth 1.3 miliard lekë në një kohë që të ardhurat janë rritur me 584 milion lekë. Kjo ka sjell dhe një rënie në mbulimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Në detaje konstatohet se rritjen më të madhe të kostove të O&M e përbëjnë zërat e personelit, të energjisë dhe materialeve, përkatësisht kostot e punës, (+516,4 milion), kostot e materialeve (+343.3 milion) dhe kostot e energjisë (+287.2 milion).

Kostot e Punës. Fokusi kryesor i punës manaxhuese të shoqërive duhet të jetë në uljen e numrit të stafit të panevojshëm dhe motivimin më tej financiar të atyre që performojnë. Aktualisht numri i punonjësve në vend që të zvogëlohej është rritur në total me 254 punonjës.

Kosto e Materialeve. Për këtë zë të kostos kërkohet një analizë më e thelluar për (mos) justifikimin e kostove të materialeve. Ky zë lidhet ngushtësisht edhe me **Kostot e Riparimeve**, sidomos me numrin dhe karakterin e defekteve në sistemet e FU dhe KUN që ka realizuar shoqëria gjatë vitit.

Kostot e Energjisë. Energjia e konsumuar për vitin 2019 raportohet e rritur me rreth 15 milion KWh krahasuar me vitin 2018. Një pjesë e saj është e justifikuar sepse nga zgjerimi i shërbimit duke marrë zonat e pa shërbyera rezulton një rritje e vëllimit të ujit të prodhuar me ngritje mekanike me rreth 3 milion m³. Për përmirësimin e këtij treguesi nevojitet hartimi i raporteve për efiçencën e energjisë. Në këto të fundit, rol kryesor kanë përmirësimi i rendimentit të pompave duke i zëvendësuar ato me të reja, si dhe rishikimi i skemave hidraulike drejt atyre më racionale teknikisht. Ulja e kostove të energjisë, lidhet gjithashtu edhe me përpjekjet për të ulur treguesin e Ujit Pa të Ardhura nga pompimi i panevojshëm i volumit të ujit që në fakt shpërdorohet ose vidhet.

Kostot e Shërbimeve të Kontraktuara. Në shërbimet e kontraktuara me të tretët një peshë të konsiderueshme zënë shërbimet e kontraktuara për rojet private. Për vitin 2019 janë 36 shoqëri që e kryejnë pjesërisht ose tërësisht këtë shërbim nga shoqëri të licencuara. Në totalin e shërbimeve të kontraktuara vetëm UK Tiranë konsumon 583 milion lekë ose 74% të totalit prej 792 milion lekëve.

Kostot të Tjera Operacionale. Përfshihen kostot e qerave për zyrat, vendimet gjyqësore, detyrimet ndaj institucioneve si ERRU, SHUKALB, Agjencive të Baseneve ujore etj. Nga vlera e raportuar në total prej 708 milion lekë, peshën më të madhe me 344 milion ose rreth 48 % e kanë vetëm UK Tiranë dhe UK Durrës respektivisht me 234 milion dhe 110 milion lekë.

Rritja e Kostove të O&M për vitin 2019 me 1,988,454 lekë në krahasim me vitin 2018 do të jetë subjekt i një analize të thelluar nga ERRU që do të reflektohet në raportin Vjetor të Performancës së Sektorit Ujësjellës Kanalizime që do të publikohet në fund të muajit qershor 2020.

Duke patur parasysh dimensionin e shoqërive sipas numrit të lidhjeve të ndara në tre grupe (shih Aneks 5), shoqëritë e Grupi I-rë përbëjnë 78% të kostove totale të sektorit, por arrijnë ti mbulojnë ato me të ardhura në nivelin 120%. Në këtë grup janë 8 shoqëri që i mbulojnë kostot mbi 100%, por shoqëritë e UK Vlorë dhe UK Kavajë kanë nivel mjaft të ulët të mbulimit të kostove me respektivisht 52% dhe 44%. Krahasuar me vitin paraardhës kostot OM të këtij grupi janë rritur me me 1.2 miliard lekë dhe të ardhurat me rreth 400 milion lekë, pra janë shoqëritë e grupit të I-rë që sjellin ndryshimin pozitiv apo negativ të sektorit UK.

Shoqëritë e Grupit të II-të realizojnë 1.2 miliard lekë të ardhura ndaj 1.8 miliard lekë kosto O&M, pra që arrijnë të mbulojnë vetëm 66% të tyre

Shoqëritë e grupit të III-të kanë nivele mjaft të ulëta të performancës financiare të mbulimit të kostove që fillojnë nga 28% për UK Finiq deri në 91% për UK Tropojë.

Nga sa më sipër është domosdoshmëri nevoja e agregimit të shoqërive sidomos ato të grupit të II-të dhe të III-të.

"Norma e Arkëtimit Korrente" është një tregues, i cili përcakton nivelin e arkëtimit të faturimeve të vitit 2019 për shërbimet që ofron shoqëria UK.

Ky tregues mbetet në nivelin e vitit 2018, pra 79 %. Shoqëritë që e kanë përmirësuar këtë tregues janë UK Belsh, UK Berat-Kuçovë, UK Maliq, UK Dibër, UK Lezhë, UK Devoll etj, Ndër shoqëritë me nivele mjaft të ulta të këtij treguesi (nën 60%) janë UK Kukës, UK Divjakë, UK Kavajë, UK Gjirokastër, UK Fier, UK Pustec, UK Roskovec, UK Elbasan.

Në krahasim me një performancë relativisht të mirë në të kaluarën, këtë tregues e kanë përkeqësuar shoqëritë UK Fier, Krujë, Peqin, Pogradec, ndërsa shoqëritë UK Durrës dhe UK Vorë e justifikojnë uljen e këtij treguesi për shkak të tërmetit të fuqishëm të muajit nëntor.

Shoqëritë UK duhet të rrisin akoma përpjekjet e tyre për përmirësimin e këtij treguesi si një nga drejtimet kryesore për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërive. ERRU ka në vëmendjen e saj kryesore vendosjen e objektivave agresive për shoqëritë UK gjatë procesit të analizës dhe përcaktimit të tarifave të reja të propozuara prej tyre për të minimizuar rritjen artificiale të tarifave në kurriz të një norme arkëtimit jo në nivelet e kërkuara.

"Uji Pa të Ardhura" (UPA), si treguesi më i rëndësishëm i performancës, për vitin 2019 ka mbetur në nivelin e vitit 2018 sepse prodhimi dhe faturimi kanë pësuar ndryshime që nuk japin efekt në këtë tregues. Konkretisht raportohen në total rreth 24,350 lidhje të reja dhe një rritje minimale e volumit të faturimit me rreth 668 mijë m³ ujë/vit. Rritja e volumit të ujit të faturuar duhet të ishte më e konsiderueshme, por në rritjen minimale të saj ka influencuar instalimi i 50 mijë matësve të cilat ulin konsumin mesatar për një familje me 4 persona mesatarisht nga 18 m³ në muaj në faturimin aforfe, në rreth 12m³ në muaj për familje në faturimin me matje.

Gjithsesi duke patur parasysh që rreth 48 % e volumit të ujit të prodhuar raportohet si i vlerësuar (jo me matës), ecuria e këtij treguesi duhet marrë me rezerve derisa të instalohen matës në të gjitha burimet. Pajisja me matës në burim duhet të jetë prioritet edhe në kuadër të reformës dhe që është pjesë e paketës së investimeve të reformës në sektor, por që gjithsesi ERRU ia adreson shoqërive UK në rekomandimet që shoqërojnë miratimin e tarifave të propozuara.

Në lidhje me këtë tregues ka shumë shoqëri që kanë nivel të kënaqshëm të tij, si UK Belsh, Devoll, Dibër, Ersekë, Lezhë dhe Korçë, ndërkohë që ndër shoqëritë me performancë të dobët të këtij treguesi (mbi nivelin 70%) paraqiten UK Berat Kuçovë, Cërrik, Durrës, Fier dhe Vlorë.

Për përmirësimin e UPA reforma në sektor po zbaton plane veprimi për legalizimin e lidhjeve të paligjshme, pajisjen 100% e konsumatorëve me matës, forcimin e masave administrative e penale ndaj kundërvajtësve, si dhe instalimin e matësve në burim e në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Gjithsesi reduktimi i UPA mbetet prioritet dhe një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë UK.

ERRU në kuadër të një analize të saktë të këtij treguesi ka forcuar kërkesat ndaj shoqërive UK për të paraqitur një bilanc real të ujit në sistemet e tyre të furnizimit me ujë, si një element bazë për hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e UPA-së. Për këtë gjatë vitit 2019 ERRU ka hartuar edhe një Model të Raportit të Bilancit të Ujit, i cili është konceptuar si model për hartimin e çdo raporti vjetor të bilancit të ujit, jo vetëm për sektorin në përgjithësi, por edhe për çdo Shoqëri UK në veçanti.

"Niveli i Matjes" është përmirësuar me 3.5%, krahasuar me vitin 2018. Gjatë vitit janë instaluar rreth 50 mijë matës uji. Në sektor ende raportohen 199,543 klientë pa matës nga të cilët 8,201 janë të kategorisë jo familjarë. Këto të fundit (subjekte private) referuar VKM nr. 96, datë 21.02.2007 i detyron ato që të kenë të instaluar ujëmatës me shpenzimet e tyre. Konstatohet se pothuajse të gjitha shoqëritë e kanë përmirësuar këtë tregues, ndërkohë që vetëm UK Devoll ka mundur të ketë 100% shërbimin e matur. Instalimi 100% me matës uji duhet të jetë një prioritet afat shkurtër për faktin se

po të ecet me ritmet e dy viteve të fundit në mbyllje të vitit 2022 asnjë klient nuk do të faturohet aforfe por sipas konsumit të matur.

"Efiçenca e Stafit" është 5.31 punonjës për 1000 lidhje UK me një përmirësim të pa përfillshëm prej 0.04%. Gjatë vitit 2019 numri i lidhjeve të ujit është rritur me rreth 24,349 lidhje dhe ai i kanalizimeve me rreth 31,582 lidhje, por nuk ka patur efekt pozitiv për të përmirësuar këtë tregues sepse gjatë vitit 2019 në total stafi i shoqërive UK në sektor është rritur me 254 punonjës.

Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të veçorive që paraqesin komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në plotësimin e detyrimeve ligjore në garantimin e sigurisë së veprave me personel roje. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve është i madh shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte që krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Efiçencës së Stafit.

Gjithsesi është i njohur fakti që ka mjaft staf të pajustificuar në shoqëritë UK, rritja e të cilit është evidente sidomos në vitet zgjedhore siç ishte viti 2019. ERRU e ka në vazhdimësi prioritet të punës së saj analizën e thelluar të organigramës dhe numrit të stafit që operon shoqëria. Shoqëritë duhet të justifikojnë secilin pozicion të stafit të saj dhe me përkrahimin përkatës të punës. Veçanërisht, kjo analizë do të zhvillohet kur shoqëria aplikon për tarifa të reja shoqëruar me një plan biznesi 5 vjeçar.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" është përmirësuar si tregues 13.2 orë/24 kundrejt 12.7 që ishte përgjatë vitit 2018. Në fakt raportimi i këtij treguesi duhet marrë me rezervë pasi ai vlerësohet apriori dhe jo në vlerësime të hollësishme sipas zonave shpërndarëse të shërbimit.

Në përfundim ERRU nisur nga informacioni paraprak që disponon, pavarësisht rezervave në saktësinë e të dhënave dhe problematikave të hasura nga shoqëritë gjatë vitit 2019, konstaton një tendencë përmirësimi në disa tregues shumë të rëndësishëm siç është ai i Nivelit të Matjes dhe Efiçencës së Stafit si dhe kohëzgjatjes së furnizimit me ujë. Gjithsesi një vlerësim përfundimtar mbi performancën e sektorit do të jepet nga ERRU në raportin vjetor për performancën e vitit 2019 ku është mundësia e një vlerësimi më të detajuar dhe të përjashtimit të ndonjë të dhëne evidente të pabesueshme.

4.2 Subvencionet

Qeveria Qendrore nëpërmjet AKUM-it i ka shpërndarë shoqërive UK një vlerë totale subvencionesh prej 700 milion lekë. Shpërndarja e subvencioneve është realizuar përkatësisht me rreth 300 milion lekë si incentiva bazuar në kriteret e arritura të kontratës së performancës, dhe 400 milion për subvencionimin e diferencave të kostove me të ardhurat me të cilat operojnë shoqëritë. Tabela në Aneks 6, jep në mënyrë të detajuar shpërndarjen e subvencioneve për të gjitha shoqëritë UK sipas kriterëve të cituara më sipër.

Nga tabela dallohen disa shoqëri që kane përfituar vetëm subvencione në formë incentivash për performancë relativisht të mirë, shoqëritë e bashkive Malësi e Madhe, Lezhë, Tiranë, Kamëz, Burrel, Korçë, Pustec, Bilisht, Ersekë, Berat-Kuçovë, Fier dhe Sarandë.

Pjesa me e madhe e subvencioneve të shpërndara për mbulimin e diferencës së kostove është alokuar përkatësisht për shoqëritë UK të bashkive, përkatësisht Shkodër, Vau i Dejës, Kavajë, Rrogozhinë, Peqin, Ura Vajguore, Lushnje, Patos, Mallakastër, Vlorë dhe Tepelenë. Këto shoqëri duhet të rrisin përpjekjet për përmirësimin e performancës financiare të tyre në drejtim të uljes së kostove dhe shtimit të të ardhurave, monitorimi i të cilave do të jetë në fokusin e punës të ERRU-së.

4.3 Investimet në Sektorin UK për Vitin 2019

4.3.1 Investimet nga Buxheti i Shtetit

Është i njohur fakti që sektori i ujësjellës kanalizimeve në vendin tonë ka nevoja mjaft të mëdha për investime fizike për të përmbushur kërkesat e Direktivës Evropiane të Ujit të Pijshëm dhe Ujërave të Ndotura. Nga një vlerësim i rishikuar i Master Planit Kombëtar për këtë fushë rezultojnë se nevojat për investime fizike në sektor të jenë rreth vlerës së 5 miliard Euro. Për përmbushjen e këtyre kërkesave rezultojnë se kërkohen rreth 200 milion Euro/vit duke patur parasysh projektimin e saj në 25 vite.

Mënyra e synuar e financimit të nevojave fizike të sektorit përcaktohet nga draft Strategjia e Financimit të sektorit nëpërmjet sistemit të 3T-ve, përkatësisht nga Taksat në buxhetin e shtetit, Transferta nga financimi i donatorëve, si dhe nga Tarifatat e shërbimeve që ofrojnë shoqëritë UK për konsumatorët.

Theksohet fakti që në kuadër të vazhdimësisë së reformës në sektor qeveria qendrore e ka patur në fokus kontributin në rritje nga buxheti i shtetit për investimet në fushën e ujësjellës kanalizimeve.

Qeveria Qendrore për vitin 2019 ka planifikuar një fond investimesh në fushën e ujësjellës kanalizimeve prej 4,432 miliard lekë që janë ekuivalente me rreth 35 milion Euro, fond i cili nuk përfshin edhe kontributin e buxhetit të shtetit për projektet në vazhdim ose të reja të donatorëve në këtë fushë.

Tabela 10 jep në mënyrë sintetike ndarjen e buxhetit të shtetit për vitin 2019 për investimet fizike në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

Tabela 10. Buxheti i Shtetit për Investimet në Ujësjellës Kanalizime për Vitin 2019

Nr.	Përshkrimi	Vlera (000 Lekë)
1	Objekte para vitit 2018	1,911,000
2	Objekte të reja 2018	601,000
3	Detyrime të prapambetura	67,000
4	Objekte të reja 2019	1,082,000
5	TVSH dhe Taksa Doganore	454,000
	Totali	4,432,000

Burimi: AKUM

Nga vlerat e mësipërme veçohen pjesa prej rreth 300 milion lekë e planifikuar në mbështetje të reformës në sektor, ku një pjesë e mirë e së cilës është shpenzuar për objekte dhe sisteme të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për bashkitë, përkatësisht, Durrës 76,6 milion Lekë, Malësi e Madhe 50 Milion Lekë, Rrogozhinë 49,5 milion lekë, Vau i Dejës 35 milion lekë, si dhe për studime dhe projekte për rreth 80 milion lekë.

Një raport më të detajuar për investimet në sektor do të jepet në Raportin Vjetor të Performancës së Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve për Vitin 2019 që do të hartohet dhe botohet nga ERRU në fund të muajit qershor 2020.

4.3.2 Investimet nga Donatorët e Huaj

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar zbatimi i projekteve me financime të huaja të llojit grante ose kredi në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Donatorët e huaj gjatë vitit 2019 kanë investuar (zbatim punimesh) në total rreth 34 milion Euro kundrejt vlerës totale të projekteve prej rreth 200 milion Euro. Tabela 11 jep listën e projekteve që kanë qenë aktive (kanë disbursuar fonde) nga donatorë të ndryshëm në të cilën nuk përfshihen kontributet lokale apo ato të rimbursimeve të taksave doganore dhe të TVSH-së.

Nga këto projekte veçohen si të realizuara në vlera të konsiderueshme ato të financuara nga BB dhe BEI për Durrësin, projekti në mbështetje të rrjetit hidrik të Tiranës financuar nga Qeveria Italiane, si dhe programi i infrastrukturës bashkiake III dhe IV financuar nga KfW dhe SECO.

Tabela 11. Realizimi i Projekteve të Investimeve të Huaja gjatë Vitit 2019 në Sistemet e Ujësjellës KUZ

Projekti	Donatori Lloji i Financimit	Vlera Totale e Projektit (në 000 Lekë)	Realizimi për Vitin 2019 (në 000 Lekë)
Mbështetje për Rrjetin Hidrik të Tiranës	Qeveria Italiane (Kredi)	1,447,036	869,879
Projekti i KUZ të Tiranës së Madhe	Qeveria Japoneze (Kredi)	9,750,841	100,227
Projekti i Ri i FU për Qytetin Durrës	BB, BEI (Kredi)	8,750,000	2,517,427
Programi i Infrastrukturës Bashkiake III e IV	KfW/SECO (Kredi/Grante)	7,019,600	766,809
Periferitë Urbane të Tiranës, Komponenti Infrastrukturor	Qeveria Italiane (Kredi)	131,180	25,437
Infrastruktura Bashkiake V	KfW, EU, SECO (Grante)	46,900	217,976
	Totali	27,145,557 (203,371,000 Euro)	4,497,755 (33,696,562 Euro)

Siç shihet vlera e investimeve të financuara nga donatorët e huaj është pothuajse e barabartë me atë të Qeverisë Qendrore në fushën e ujësjellës kanalizimeve. Në total kontributi nga buxheti i qeverisë dhe nga donatorët e huaj llogaritet rreth 70 milion Euro, që përfaqëson rreth 35 % të nevojave të sektorit (200 milion Euro) të përmendura më sipër referuar vlerësimin nga Master Plani dhe projektimit të nevojave për një periudhë 25 vjeçare.

Akoma financimi aktual në sektor nuk i përgjigjet nevojave reale në përbushje të tre Direktivave Evropiane për Ujin e Pijshëm dhe Ujërat e Ndotura*, ku vendi ynë synon të hapë së shpejti negociatat për aderimin në Komunitetin Evropian.

* *Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian (Direktiva e Politikave të Ujit).
Direktiva 98/83/EC (Direktiva e Ujit të Pijshëm);
Direktiva 91/271/EEC (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura)*

5 Situata në Zbatim të Reformës në Sektorin e Ujit

Reforma në sektorin e ujit e cila i ka fillimet e saj në janar 2016 në zbatim të VKM nr. 63, i cili parashikonte riorganizimin e shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki.

Riorganizimi i sektorit ishte një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në VKM. Procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të asetëve dhe me pas regjistrimi i tyre në QKB paraqitej mjaft problematik, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës nga ish komunat.

Aktualisht shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin sipas ndarjes së re territoriale, por nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas parashikimeve që kishte procesi i riorganizimit. Procesi parashikonte gjithashtu që brenda 3 muajve nga përfundimi i tij shoqëritë duhet të aplikojnë pranë Entit Rregullator të Ujit për licencim dhe miratimin e tarifave të reja për të gjithë zonën e re të shërbimit.

Deri në fund të viti 2019 janë licencuar nga ERRU 49 shoqëri UK nga 57 që është totali i tyre, pra me 7 shoqëri më shumë të licencuara se viti 2018 (shih Tabelën 2, Aneks 1) dhe janë akoma në proces dy (2) shoqëri, përkatësisht UK Tirana dhe UK Pustec. ERRU po ndjek nga afër dhe inkurajon procesin e riorganizimit dhe përfundimit të licencimit të të gjithë shoqërive UK në përputhje me riorganizimin e tyre sipas reformës.

Reforma është akoma në proces zbatimi dhe po ndiqet nga afër gjithashtu nga AKUM në zbatim të kontratave të performancës të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkive bazuar në tregues performance që në mjaft raste janë të përcaktuara apriori. AKUM duhet të rrisë përpjekjet së bashku me shoqëritë UK përkatëse në përcaktimin më të saktë të vlerave të Treguesve Kryesorë të Performancës si bazë e këtyre Kontratave që kushtëzojnë shpërndarjen e subvencioneve, si dhe të incentivave për investimet fizike. Gjithsesi ndjekja e reformës nga AKUM ka dhënë rezultate pozitive për sektorin në drejtim të :

- eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rezultat i aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar u arrit të evidentohet një numër i konsiderueshëm lidhjesh ilegale, kjo ndikoj edhe në rritjen e numrit të klientëve;
- rritjes së numrit të ujëmatësave të vendosur: pothuajse të gjitha shoqëritë për vitin 2018 kanë shtuar numrin e ujëmatësave të instaluar, kjo ka ndikuar edhe në përmirësimin e treguesit niveli i matjes;
- arkëtimeve të debive të prapambetura: u rrit ndjeshëm përgjegjshmëria qytetare për likuidimin e debive të prapambetura duke u bërë pjesë e marrëveshjeve individuale për shlyerjen e tyre.

Gjithsesi, në fund të vitit 2019 megjithë përmirësimin e lehtë të gjendjes financiare të sektorit, rezultoi se nuk u arritën pritshmëritë e parashikuara nga reforma sidomos në drejtim të influencës së uljes së humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme. Për uljen e humbjeve dhe hartimin e një plani veprimi për zvogëlimin e tyre me asistencën e huaj, financuar nga GIZ, u realizua një studim për tetë shoqëritë UK më të mëdha të vendit që ofrojnë shërbime për mbi 70% të popullsisë së vendit.

Në fund të vitit 2019, për përsheptimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MIE përpiloi një qasje që akoma është në diskutim me të gjithë aktorët në sektor para se të formalizohet për

zbatim. ERRU ka komentet e saj në drejtim të mundësisë të realizimit të saj në praktikë që i ka diskutuar në mbledhjet përkatës me aktorët për këtë qellim.

Qasja e propozuar për shëndoshjen e sektorit të ujësjellës kanalizimeve bazohet në ndarjen në dy kategori të shoqërive UK, përkatësisht në ato që operojnë duke mbuluar kostot e O&M dhe në ato të cilat kanë nevojë për subvencionim nga Qeveria Qendrore.

Propozimi merr në konsideratë shoqëritë e kategorisë që kanë nevojë për subvencion nga qeveria qendrore dhe propozon një Plan Veprimi për to me një shtrirje kohore zbatimi rreth dy vjeçare. Theksohet fakti se janë 44 nga 57 shoqëri UK që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M. Për këtë kategori të shoqërive, në princip, qasja propozon agregimin e tyre “të detyruar” në një shoqëri të vetme që do të menaxhohet nga një staf qendror (Struktura e Kompetencave të Përbashkëta ose SKP). Krijimi i një shoqërie të tillë gjigande nuk rekomandohet të krijohet, sepse eksperiencia ndërkombëtare dhe ajo e vendeve me kushte të përafërta me tonat nuk njojnë shembull suksesi ku sektori (shitja e ujit me pakicë) është agreguar pothuajse në mënyrë të menjëhershme.

Shëndoshja afatshkurtër financiare e sektorit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit pritet të vijë kryesisht nga reduktimi i fuqisë punëtore dhe rritja e normës së arkëtimit. Lënia në njëfarë mënyre, e bashkive jashtë procesit kompromenton sidomos faktorin e dytë (normën e arkëtimit), ku roli i bashkisë është mjaft i rëndësishëm në mbështetje kundër debitorëve dhe abuzuesve.

Studimi i bëshmërisë i vitit 2008 për agregimin e sektorit të ujit në Shqipëri, financuar nga Banka Botërore, ka konkluduar se agregimi duhet realizuar mbi baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Procesi duhet të jetë diskret (kërkon kohën e duhur), gradual, mbështetje me fonde (incentiva) dhe me angazhim të fortë institucional të pushtetit qendror dhe atij vendor.

Nga ana tjetër, krijimi i shoqërisë së agreguar në përmasa të tilla, në kufi kohorë mjaft të shkurtër, është pothuajse i pamundur të realizohet. Afati minimal për plotësimin e kërkesave burokratike të krijimit dhe vënies në operim të shoqërisë së agreguar është rreth 2 vjet.

Për sa më sipër, ERRU për vazhdimësinë e reformës në sektorin e ujit ka rekomanduar:

- Të vazhdohet procesi i vlerësimit të treguesve të performancës (të arritjes së objektivave) për secilën shoqëri UK, si proces mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e instrumentave përkatës për shëndoshjen financiare të tyre;
- Në kontratat e reja të performancës AKUM duhet të vlerësojnë sesa janë treguesit e performancës, të dakortësojë me shoqëritë objektivat që duhen arritur prej saj në fund të vitit 2020.
- Duhet të nisët procesi i agregimit të shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar që fillimisht të realizohen 2-3 agregime të suksesshme. Seleksionimi i rasteve të mundshme me pritshmëri pozitive duhet të bazohet në një studim anketimi të të gjithë bashkive të vendit ku mund të zbatohet principi i mësipërm.

6 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2020

- ❖ Në rast të mos aprovimit të projekt-ligjit të ri për sektorin e ujësjellës kanalizimeve të ndjekë procedurat për rishikimin e Ligjit nr. 8102 deri në miratimin përfundimtar të tij.
- ❖ Përfundimin e punës për rishikimin dhe hartimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave për shërbimin e UK", në përputhje me kërkesat për një menaxhim bashkëkohor të sektorit dhe përfshirjen e eksperiencave më të mira të rregullatorëve Evropianë në të.
- ❖ Me mbështetjen e asistencës së donatorëve të synojë rishikimin e Kodit të Ujit (Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime).
- ❖ Me mbështetjen e asistencës së donatorëve të synohet hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, përfshirë dhe trajnimet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shumë shoqërive UK në sektor, si një nga drejtimet kryesore të strategjisë për përmirësimin e performancës në sektor mjaft të fragmentarizuar me 57 shoqëri UK.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues për rishikimin e nën akteve ligjore që lidhen me Akt Miratimin Higjieno Sanitar që duhet të përfitojnë Shoqëritë UK për tu pajisur me Licence nga ERRU.
- ❖ Të hartojë dhe të botojë raportin vjetor të performancës së sektorit UK për vitin 2019 bazuar në platformën e data bazës të miratuar nga KKRR me të dhënat e grumbulluara nga shoqëritë UK të përmirësuara në drejtim të saktësisë dhe besueshmërisë.
- ❖ ERRU të forcojë përpjekjet për forcimin e rolit të ERRU në mbështetje dhe asistencë për zgjidhjen e problemeve me ankesat e konsumatorëve në respektim të Kodit të Ujit në veçanti, dhe të legjislacionit në fushën e ujësjellës kanalizimeve në përgjithësi.
- ❖ Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjëra dhe bilaterale me rregullatorët Evropianë të sektorit të ujit.
- ❖ Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK dhe në veçanti të kuadrit rregullator.
- ❖ Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorëve të tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve.

7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit

- Rishikimi dhe aprovimi i ndryshimeve të ligjit nr. 8102 për Entin Rregullator të Ujit të propozuara nga ERRU në Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht miratimit ose jo të projekt-ligjit për sektorin e ujit.
- Shfuqizimi i Kodit aktual të Ujit (Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime) dhe rishikimi dhe aprovimi i tij nga ERRU, si domosdoshmëri në përgjigje të kërkesave aktuale të sektorit, dhe në veçanti për një marrëdhënie dhe trajtim sa më objektiv të ankesave të konsumatorëve.
- Hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK nga ERRU, si dokumenti bazë në mbështetje të justifikimit të tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK, dhe si instrument i domosdoshëm për përmirësimin e manaxhimit të shoqërive në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tyre.
- Hartimi i nënakteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjieno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjieno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nënakteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rrisht të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, si një domosdoshmëri për zgjidhjen e problemit të licencimit të shoqërive UK.
- Të nisë sa më shpejt të jetë e mundur procesi i agregimit të Shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës bazuar në principin “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, ku ERRU duhet të para vlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Të nxitet përmirësimi i performancës së Shoqërive UK nëpërmjet hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Tregues Performance dhe Objektiva të vlerësuara në përputhje me gjendjen reale të Shoqërive UK dhe ambicioze për të ardhmen.

Aneksi 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2019

Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje dhe shoqëritë që janë ende në proces

Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR			
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi ligjor	Ndryshim Drejtuesi teknik	Operatorë të rinj
1	Sh.A.UK Berat - Kuçovë		X		
2	Sh.A.UK Elbasan	X			
3	Sh.A.UK Mallakastër	X			
4	Sh. A. UK Vau i Dejës (ka aplikuar dy herë)	X	X		
5	Sh. A. U Këlcyrë				X
6	Sh.A.UK Vorë			X	
7	Sh.A.UK Cërrik		X		
8	Sh.A.UK Dibër (ka aplikuar dy herë)		X	X	
9	Sh.A.UK Fushë Arrëz	X			
10	Sh.A.UK Gjirokastrë (ka aplikuar dy herë)		X	X	
11	Sh.A.UK Himarë	X			
12	Sh.A.UK Peqin	X			
13	Sh.A.UK Rrogozhinë		X	X	
14	Sh.a. UK Pukë	X			
15	Sh. A. U Gramsh			X	
16	Sh.A.UK Përmet	X			
17	Sh.A.UK Fier	X			
18	Sh.A.UK Berat - Kuçovë			X	
19	Sh. A UK Tepelenë			X	
20	Sh. A UK Librazhd			X	
21	Sh.A.UK Pustec				X
22	Sh.A.UK Tiranë	X			

 Pesë (5) shoqëri UK që janë në proces të rinovimit të licencës

Tabela 2. Situata e Gjendjes së Licencimit të Shoqërive UK - 2019

Nr.	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi Mbarim afati, ndryshim drejtuesi ligjor/teknik, ndryshim zone shërbimi, shoqëri e re	Me Licencë të pavlefshme dhe që nuk kanë aplikuar	Asnjëherë të pajisur me licencë
1	Sh.a. UK Gjirokastër	Sh.a. UK Pustec	Sh.a U Divjakë	Sh.a UK Kamëz
2	Sh.a. UK Devoll	Sh.a. UK Tiranë	Sh.a. UK Mirditë	Sh.a. UK Klos
3	Sh.a. UK Lushnjë		Sh.a. U Selenicë	
4	Sh.a. UK Lezhë		Sh.a. U Bulqizë	
5	Sh.a. UK Tepelenë			
6	Sh.a. UK Dibër			
7	Sh.a. UK Korçë			
8	Sh.a. UK Durrës			
9	Sh.a. UK Fier			
10	Sh.a. UK Mat			
11	Sh.a. UK Delvinë			
12	Sh.a. UK Berat - Kuçovë			
13	Sh.a. UK Patos			
14	Sh.a. UK Kurbin			
15	Sh.a. UK Ura Vajgurore			
16	Sh.a. UK Librazhd			
17	Sh.a. U Gramsh			
18	Sh.a. UK Malësi e Madhe			
19	Sh.a. UK Kukës			
20	Sh.a. UK Vorë			
21	Sh.a. UK Kolonjë			
22	Sh.a. UK Pogradec			
23	Sh.a. UK Krujë			
24	Sh.a. UK Poliçan			
25	Sh.a. UK Vau i Dejës			
26	Sh.a. UK Belsh			
27	Sh.a. UK Maliq			
28	Sh.a. UK Cërrik			
29	Sh.a. UK Vlorë			
30	Sh.a. UK Skrapar			
31	Sh.a. UK Shkodër			
32	Sh.a. UK Roskovec			
33	Sh.a. UK Tropojë			
34	Sh.a. UK Sarandë			
35	Sh.a. UK Libohovë			
36	Sh.a. UK Rrogozhinë			
37	Sh.a. UK Dropull			
38	Sh.a. UK Kavajë			
39	Sh.a. UK Has			
40	Sh.a. UK Himarë			
41	Sh.a. UK Finiq			
42	Sh.a. UK Konispol			
43	Sh.a. UK Elbasan			
44	Sh.a. U Këlcyrë			
45	Sh.a. UK Mallakastër			
46	Sh.a. UK Fushë Arrëz			
47	Sh.a. UK Përmet			
48	Sh.a. UK Peqin			
49	Sh.a. UK Pukë			

Aneksi 2 - Vlera e Faturës Mujore (me TVSH) për Klientët Familjarë Viti 2019

Operatori		Fatura aktuale	Fatura e Propozuar nga Operatori	Fatura sipas Vendimit KKRR	Shpenzime mesatare sipas Qarqeve *	Fatura ndaj të Ardhurave Mesatare
		12 m3/lidhje	12 m3/lidhje	12 m3/lidhje		
Sh.a UK Gjirokastër	Gjirokastër	860	1,001	946	66,238	1.43%
	Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie	360	456	456	66,238	0.69%
Sh.a UK Poliçan	Poliçan	662	1,020	1,013	70,737	1.43%
	Vërtop	883				
	Tërpan	pa shërbim				
Sh.a UK Delvinë		1,132	1,295	1,295	68,227	1.90%
Sh.a UK Tropojë	Bajram Curri		883	883	66,326	1.33%
	Bujan Bytyc Fierzë, Llugaj, Margega, Tropojë, Lekbibaj			552	66,326	0.83%
Sh.a UK Malësi e Madhe		920	1,093	1,093	73,441	1.49%
Sh.a UK Lushnje	Lushnje	1,200	1,361	1,258	71,117	1.77%
	Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk / Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë	864				
Sha UK Berat Kuçovë	Berat, Kuçovë	998	1,116	1,042	70,737	1.47%
	Otlak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas	1,042				
	Roshnik	898				
Sh.a UK Vlorë	Qendër Vlorë, Vlorë	686	1,476	984	68,227	1.44%
	Novoselë	475	900			
	Orikum	480	720			
	Shushicë	528	720			
Sh.a UK Krujë	Krujë	590	739	739	75,744	0.98%
	Fushë-Krujë	489				
Sh.a UK Himarë			1,536	1,464	68,227	2.15%
Sh.a UK Roskovec			989	1,145	71,117	1.61%
Sh.a UK Vorë			1,711	1,392	88,691	1.57%

Aneksi 3 - Shoqëritë e riorganizuara dhe të licencuara sipas reformës

Nr.	Shoqëri të Licencuara sipas Reformës			
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë	Sh.a UK Libohovë	Sh.a UK Pukë
2	Sh.a UK Vorë	Sh.a U Gramsh	Sh.a UK Dropull	Sh.a UK Elbasan
3	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Korçë	Sh.a UK Konispol	
4	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Krujë	Sh.a UK Tropojë	
5		Sh.a UK Mirditë	Sh.a UK Vlorë	
6		Sh.a U Poliçan	Sh.a UK Rrogozhinë	
7		Sh.a UK Berat Kuçovë	Sh.a UK Kavajë	
8		Sh.a UK Devoll	Sh.a UK Sarandë	
9		Sh.a UK Maliq	Sh.a UK Ura Vajgurore	
10		Sh.a UK Patos		
11		Sh.a UK Skrapar		
12		Sh.a UK Vau Dejës		
13		Sh.a UK Tepelenë		
14		Sh.a UK Delvinë		
15		Sh.a UK Lezhë		
16		Sh.a UK Pogradec		
17		Sh.a UK Shkodër		
18		Sh.a UK Cërrik		
19		Sh.a UK Roskovec		
20		Sh.a UK Mat		
21		Sh.a UK Lushnje		
22		Sh.a UK Librazhd		

Aneksi 4 – Trajnimet - Viti 2019

Drejtoria	Trajnimi/Aktiviteti	Punonjës pjesëmarrës	Ditë brenda vendit	Ditë jashtë vendit
Drejtoria Teknike Ekonomike	Seancë me grupin Valu ADD në UK Fier për Menaxhimin e Humbjeve me ekspertin Bambos Charalambous, Fier. (1 ditë)	4	4	0
	Workshopi i Programit të Infrastrukturës Bashkiake III dhe IV (MIP III + IV) mbi progresin e shoqërive pjesë e projektit të financuar nga KfW, 20 Mars 2019, Hotel Bleart, Durrës. (1 ditë)	1	1	0
	Konferenca " Achieving resiliency in water and wastewater utilities in the Danube region ", 20 - 22 Maj 2019, Vienë. (3 ditë*)	2	0	6
	Takimi i II-të i Komitetit Drejtues Mbështetja e Bashkimit Evropian në Reformën e Sektorit të Ujit në Shqipëri", 27 qershor 2019, Tiranë. (1 ditë)	1	1	0
	Takim pune organizuar pranë Rregullatorit të Portugalisë, 3-4 Korrik 2019, Lisbonë.(2 ditë*)	1	0	2
	ASPA "Investimet Publike" Tetor 2019 (2 ditë)	5	10	0
	Konferenca dhe Ekspozita e 7-të e Përbashkët Ballkanike, Prishtinë 06-08 Nëntor 2019 (3 ditë*)	3	0	9
	Seancë me grupin Valu ADD në UK Elbasan për Menaxhimin e Humbjeve me ekspertin Bambos Charalambous, Elbasan. (1 ditë)	4	4	0
	Programi "EDAMS" mbi Menaxhimin e Aseteve të Shoqërive UK, 26.02.2019, Tiranë.(1ditë)	4	4	0
	Workshopi Kombëtar i "Uji pa të Ardhura në Shqipëri", 17 prill 2019,Tiranë (1 ditë)	2	2	0
	Sustainable Tariffs for Water Services Conference 2019" mbi qëndrueshmërinë e tarifave për shërbimin me ujë, 14-15 Mars 2019 në Lisbonë, Portugali (2 ditë*)	2	0	4
	Shërbime Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për shoqëritë UK në Evropën Juglindore" mbi fazën e I-rë të trajnimit për programin "EDAMS", 27 - 29 Mars 2019,Tiranë (3 ditë)	2	6	0
	Shërbime Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për shoqëritë UK në Evropën Juglindore" mbi fazën e II-të të trajnimit për programin "EDAMS", 3 - 4 Tetor 2019 Kosovë.(2 ditë*)	2	0	4
	"Southeast Europe Regional Conference Water Loss", 22-24 Shtator 2019, Rumani (3 ditë*)	3	0	9
	Workshopi Kombëtar i "Uji pa të Ardhura në Shqipëri", 17 Prill 2019, Tiranë (1ditë)	2	2	0
	ASPA "Investimet Publike" 24 - 25 Qershor. (2 ditë)	2	4	0
	ASPA "Prokurimi Publik", (niveli mesatar) 1 - 5 Korrik . (5 ditë)	1	5	0
	ASPA "Prokurimi Publik" (niveli i avancuar, 21 - 25 Tetor 2019 (5 ditë)	1	5	0
Drejtoria Juridike dhe Konsumatorit	ASPA "Përafrimi i legjisllacionit" Niveli I, Korrik (1ditë)	1	1	0
	ASPA "Negocimi e vendimmarrja" 22 - 23 Korrik (2 ditë)	1	2	0
	ASPA "Prokurime Publike Nivel i avancuar" 10 - 12 Korrik (3 ditë)	1	3	0
	ASPA " Prokurim publik nivel mesatar" 1 - 5 Korrik (5 ditë)	1	5	0
	Konferenca e 7-të të Përbashkët Ballkanike zhvilluar, Prishtinë, 06-08 Nëntor 2019 (3 ditë*)	2	0	6
	ASPA "Përafrimi i legjisllacionit" Niveli II Korrik 2019 (2 ditë)	1	2	0
	Takimin e 18-te i WAREG, Vilnius (2 ditë*)	1	0	2
	Trajnim 2 javor në Hagë "Qeverisja e ujit në nivele të ndryshme" Organizuar nga Akademia Lokale e Hagës (14 ditë*)	1	0	14
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	ASPA "Kodi i Procedurës Administrative" Nëntor (1 ditë)	1	2	0
	ASPA "Monitorimi e Vlerësimi" Korrik 2019 (2 ditë)	2	4	0
	ASPA "Investimet Publike" Tetor 2019 (2 ditë)	1	2	0
	ASPA "Prokurim Publik" Tetor 2019 (5 ditë)	1	5	0
	ASPA "Planifikimi Strategjik" Korrik 2019 (2 ditë)	1	2	0
			76	56

Aneksi 5 – Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2019

Grupimi	Shoqëritë	Mbulim i kostos totale	Mbulimi i kostos Direkte O&M	Niveli i matjes	Norma e arkëtimit e përgjithshme	Norma e Arkëtimit Korente	Efiçenca e stafit U+K	Humbjet, Uji pa të ardhura	Mbulimi me kanalizime	Mbulimi me ujësjellës	Furnizimi me ujë
Grupi 1	UK Tiranë	130%	162%	88%	98%	87%	3.80	60%	91%	97%	12.50
	UK Durrës	85%	101%	94%	73%	59%	3.89	73%	60%	94%	8.30
	UK Vlorë	40%	52%	57%	117%	85%	4.21	78%	58%	94%	13.00
	UK Elbasan	73%	94%	72%	66%	44%	4.59	77%	61%	74%	12.00
	UK Fier	91%	113%	65%	81%	55%	6.01	72%	38%	68%	22.00
	UK Shkodër	49%	86%	66%	87%	68%	6.09	69%	44%	55%	20.80
	UK Korçë	76%	181%	95%	93%	79%	1.58	31%	65%	90%	24.00
	UK Berat Kuçovë	92%	136%	74%	101%	89%	4.88	73%	54%	71%	12.00
	UK Kavajë	42%	44%	31%	39%	33%	4.90	41%	38%	100%	4.00
	UK Lushnje	53%	77%	94%	86%	65%	5.84	74%	37.7%	75%	5.00
	UK Sarandë	76%	123%	95%	91%	78%	2.59	51%	74%	100%	12.00
UK Kamëz	56%	88%	66%	124%	80%	2.67	62%	53%	48%	4.00	
UK Lezhë	51%	145%	85%	89%	89%	3.77	38%	59%	71%	21.00	
UK Pogradec	53%	118%	89%	110%	64%	3.85	35%	50%	93%	21.60	
Totali Grupi I-rë		88%	120%	80%	91%	77%	4.42	66%	68%	84%	13
Grupi 2	UK Maliq	69%	69%	88%	106%	92%	5.68	40%	24%	66%	14.00
	UK Gjirokastrë	49%	95%	54%	60%	42%	9.03	44%	39%	100%	13.00
	UK Devoll	78%	93%	100%	100%	65%	5.31	29%	0%	86%	22.00
	UK Dibër	174%	182%	52%	86%	86%	7.37	37%	81%	92%	9.00
	UK Kurbin	31%	33%	23%	96%	96%	8.33	66%	37%	46%	4.00
	UK Cërrik	66%	70%	82%	116%	89%	7.31	71%	27%	57%	22.00
	UK Belsh	63%	66%	86%	101%	97%	10.01	13%	14%	94%	15.00
	UK Kukës	107%	131%	35%	80%	49%	6.13	21%	42%	75%	24.00
	UK Librazhd	66%	74%	99%	91%	58%	5.20	65%	21%	28%	24.00
	UK Mat	82%	91%	63%	68%	38%	7.54	44%	46%	82%	16.00
	UK Divjakë	48%	51%	96%	41%	38%	11.84	53%	0%	55%	4.00
	UK Himarë	76%	81%	92%	141%	69%	6.55	67%	23%	90%	14.00
	UK Krujë	49%	57%	74%	110%	46%	7.18	61%	26%	43%	6.00
	U Patos	22%	23%	38%	105%	76%	24.68	60%	45%	50%	8.00
	UK Mallakastër	35%	41%	65%	109%	80%	15.24	65%	21%	77%	6.00
	U Gramsh	78%	93%	80%	101%	85%	8.89	39%	0%	89%	23.00
	UK Rrogozhinë	42%	53%	94%	60%	24%	8.13	63%	8%	67%	5.00
	UK Malësi e Madhe	81%	100%	61%	85%	73%	12.51	45%	35%	71%	11.00
	UK Vorë	83%	83%	66%	86%	76%	10.64	65%	48%	50%	7.50
	UK Bulqizë	87%	92%	20%	87%	69%	10	66%	0%	51%	19.00
	UK Tepelenë	23%	29%	67%	125%	89%	9.97	57%	39%	55%	24.00
U Përmet	74%	75%	92%	94%	72%	14.06	44%	0%	96%	24.00	
UK Dropull	48%	69%	19%	106%	87%	5.99	26%	1%	100%	5.50	
U Selenicë	57%	58%	8%	51%	25%	11.4	50%	36%	100%	6.50	
UK Ura Vaigurore	43%	51%	94%	104%	90%	10.16	57%	25%	51%	10.00	
UK Vau Dejës	72%	96%	72%	84%	84%	7.58	52%	2%	53%	9.00	
U Peqin	38%	40%	97%	121%	86%	23.15	68%	0%	51%	14.00	
UK Skrapar	45%	54%	42%	92%	76%	9.28	58%	46%	93%	12.00	
UK Roskovec	66%	114%	94%	39%	22%	12.04	63%	16%	50%	4.00	
UK Ersekë	111%	121%	49%	77%	76%	5.53	33%	82%	100%	18.00	
UK Delvinë	66%	86%	73%	78%	65%	6.67	46%	38%	89%	9.00	
UK Mirditë	36%	56%	67%	100%	64%	11.86	48%	40%	54%	15.00	
Totali Grupi II-të		56%	66%	68%	89%	69%	9.1	53%	22%	65%	13.38
Grupi 3	UK Poliçan	51%	54%	67%	119%	80%	7.95	41%	68%	69%	24.00
	UK Tropojë	68%	91%	77%	72%	72%	10.68	56%	25%	56%	22.00
	UK Finiq	26%	28%	59%	77%	55%	13.25	80%	0%	44%	6.00
	UK Konispol	45%	54%	42%	108%	76%	14.29	42%	46%	93%	12.54
	UK Këlcyrë	32%	35%	73%	56%	33%	19.93	80%	0%	47%	24.00
	UK Pukë	65%	87%	54%	99%	80%	10.23	62%	22%	62%	24.00
	U Has	37%	48%	71%	110%	71%	15.48	56%	0%	68%	7.00
	U Klos	47%	47%	0%	73%	55%	16.36	13%	0%	28%	4.00
	UK Libohovë	60%	65%	98%	57%	51%	11.90	46%	0%	100%	13.00
	UK Fushë Arrëz	29%	50%	43%	128%	98%	13.16	70%	60%	44%	24.00
UK Pustec	41%	46%	89%	45%	43%	11.89	50%	24%	52%	8.00	
Totali Grupi III-të		52%	60%	67%	85%	76%	11.83	60%	15%	56%	15.97
Gjendja në sektor		81.2%	108.3%	77.5%	90.9%	79.0%	5.3	63.0%	52.9%	77.2%	13.2

- Të dhënat e publikuara janë operative pasi ato përfundimtare të certifikuara jepen në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2019 që publikohet nga ERRU në muajin Qershor të vitit pasardhës, pas miratimit të bilanceve financiare nga ekspertët kontabël.

Aneksi 6 – Subvencionet e Akorduara nga Qeveria për Shoqëritë UK, Viti 2019

Nr.	Emërtimi	Detajimi i subvencionit për performance për vitin 2019	Detajimi i subvencionit për diferencë kosto për vitin 2019	Totali në leke
1	Shkodër UK Sh. a	9,434,709	20,181,000	29,615,709
2	Fushë Arrëz UK Sh. a	318,746	741,000	1,059,746
3	Pukë UK Sh. a	399,281	196,000	595,281
4	Vau Dejës U Sh. a	2,058,253	7,844,000	9,902,253
5	Malësi e Madhe U Sh. a	3,098,809	0	3,098,809
6	Lezhë UK Sh. a	6,764,860	0	6,764,860
7	Mirdite UK Sh. a	1,601,764	2,917,000	4,518,764
8	Kurbin U Sh. a	2,261,947	24,191,000	26,452,947
9	Kukës UK Sh. a	3,009,000	0	3,009,000
10	Tropojë U Sh. a	1,086,762	603,000	1,689,762
11	Has U Sh. a	643,128	2,670,000	3,313,128
12	Tiranë UK Sh. a	81,446,153	0	81,446,153
13	Kamëz UK Sh. a	6,030,128	0	6,030,128
14	Kavajë UK Sh. a	4,899,211	32,061,000	36,960,211
15	Rrogozhinë UK Sh. a	2,933,748	5,158,000	8,091,748
16	Vorë UK Sh. a	1,761,317	2,486,000	4,247,317
17	Durrës UK Sh. a	33,856,825	28,443,000	62,299,825
18	Krujë UK Sh. a	2,627,623	6,471,000	9,098,623
19	Peshkopi UK Sh. a	2,560,399	1,200,000	3,760,399
20	Bulqizë U Sh. a	1,386,001	878,000	2,264,001
21	Burrel UK Sh. a	2,827,000	0	2,827,000
22	Elbasan UK Sh. a	12,868,058	9,987,000	22,855,058
23	Librazhd UK Sh. a	1,688,391	390,000	2,078,391
24	Gramsh U Sh. a	1,948,055	759,000	2,707,055
25	Cërrik UK Sh. a	2,528,319	5,292,000	7,820,319
26	Belsh UK Sh. a	2,620,527	8,254,000	10,874,527
27	Peqin U Sh. a	2,184,185	10,065,000	12,249,185
28	Korçë UK Sh. a	10,410,892	0	10,410,892
29	Pogradec UK Sh. a	7,023,607	2,039,000	9,062,607
30	Maliq UK Sh. a	4,342,511	5,020,000	9,362,511
31	Pustec UK Sh. a	188,556	0	188,556
32	Bilisht U Sh. a	1,560,810	0	1,560,810
33	Ersekë UK Sh. a	1,410,053	0	1,410,053
34	Berat Kuçovë UK Sh. a	9,798,121	0	9,798,121
35	Ura Vajgurore U Sh. a	1,562,721	6,071,000	7,633,721
36	Poliçan U Sh. a	1,190,851	3,241,000	4,431,851
37	Çorovodë UK Sh. a	1,526,321	3,812,000	5,338,321
38	Fier UK Sh. a	11,964,765	0	11,964,765
39	Lushnje UK Sh. a	9,067,113	19,351,000	28,418,113
40	Divjakë U Sh. a	1,800,834	3,784,000	5,584,834
41	Patos U Sh. a	2,700,662	56,914,000	59,614,662
42	Roskovec UK Sh. a	1,419,753	2,747,000	4,166,753
43	Mallakastër UK Sh. a	2,687,873	11,345,000	14,032,873
44	Vlorë U Sh. a	15,088,552	82,915,000	98,003,552
45	Selenicë U Sh. a	1,581,002	4,110,000	5,691,002
46	Himarë UK Sh. a	2,126,999	989,000	3,115,999
47	Delvinë UK Sh. a	1,589,221	1,326,000	2,915,221
48	Sarandë UK Sh. a	5,913,885	0	5,913,885
49	Konispol UK Sh. a	1,329,691	3,967,000	5,296,691
50	Gjirokastrë UK Sh. a	4,749,781	2,459,000	7,208,781
51	Tepelenë UK Sh. a	1,346,114	9,701,000	11,047,114
52	Këlcyrë U Sh. a	448,071	2,367,000	2,815,071
53	Përmet U Sh. a	1,709,681	3,279,000	4,988,681
54	Libohovë UK Sh. a	618,361	3,235,000	3,853,361
55	Dropull	0	541,000	541,000
	Totali	300,000,000	400,000,000	700,000,000

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.